

# ASI

A S S E M B L Y   S U P P O R T   I N I T I A T I V E

NEWSLETTER

Tetor 2003, No 08

osce  
Mission in Kosovo

- Chris Patten i drejtohet Kuvendit të Kosovës
- Intervistë me V. Jovanović dhe I. Marković
- Porosi nga zyra Gjermane

# BE-ja dhe Kosova

Me 11 shtator të vitit 2003, z. Chris Patten, komisioner evropian përgjegjës për marrëdhënie me jashtë iu drejtua Kuvendit të Kosovës. Në pjesën kryesore të fjalimit të tij, ai u përqëndrua në prezantimin në vija të përgjithshme të politikës së UE-së ndaj Kosovës si dhe të asaj se çfarë pret UE-ja nga shoqëria kosovare dhe udhëheqësia e saj politike. Në vijim po i japim disa thekse.

## Chris Patten - Komisioner evropian përgjegjës për marrëdhënie të jashtme.

... ndjehem shumë mirë që gjendem prapë në Kosovë.

Edhe pse mendoj se në Kosovë kam qenë që dhjetëra vite me radhë, kur kam ardhur këtu për herë të parë më 1999, nuk mendoja madje as se do të mund të ëndërroja se ndonjëherë do të mund t'i drejtohem një Kuvendi që përbëhet prej liderëve politikë të zgjedhur në mënyrë demokratike këtu në Prishtinë dhe ndoshta duhet të jesh vizitor i rastit, por entuziast dhe miradashës, që të mund ta vësh progresin që ju e keni arritur në partneriritet me bashkësinë ndërkombëtare...

Çështja e statusit final të Kosovës nuk është vënë ende në tavolinë të bisedimeve. Por, ne të gjithë jemi plotësisht të sigurtë se e ardhmja juaj është në Evropë. Ky ishte zotimi i tërë Bashkësisë Evropiane në mbledhjen që është mbajtur në Selanik më qershor dhe kam kënaqësinë që sot ta konfirmoj këtë premtim....

E di ... se ju të gjithë jeni të brengosur për statusin final. Kjo nuk është temë e diskutimit të sotëm, edhe pse është e qartë se nuk mund të shtyhet deri në pafund. Me rëndësi është që ta dimë se çdokush, qoftë në Beograd, qoftë, thënë haptazi, këtu në Prishtinë, duhet t'i ndërprejë aksionet që e shkaktojnë dhe e rrisin tensionin. Kjo është çështja që unë mendoj ta bëjë të qartë si kristali nesër në Beograd. Deklaratat parlamentare kundër pavarësisë, thënë më butë, nuk janë të dobishme, por po aq të padobishme do të ishin edhe deklaratat parlamentare për pavarësinë....

Çfarë është në rend të ditës sot është nisja e një dialogu të ri dhe konstruktiv me Beogradin. Ky duhet të jetë prioriteti i të gjitha institucioneve të Kosovës dhe i UNMIK-ut: që të fillojnë dialogun me Beogradin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me jetën e përditshme të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Lansimi i dialogut do t'ia dërgonte një mesazh shumë pozitiv Bashkësisë Ndërkombëtare, sepse do të dëshmonte se liderët tuaj janë të aftë që t'i pranojnë konstruktivisht përgjegjësitë e tyre. Kjo do të tregonte qartë se kur themi se Kosova është në rrugë drejt Evropës, nuk e themi këtë vetëm për shkak se ju jeni gjeografikisht dhe politikisht pjesë e këtij kontinenti të vjetër, por sepse ju jeni mjaft të pjekur që të bisedoni me ata me të cilët keni mosmarrëveshje jashtëzakonisht të mëdha....

Shumë është bërë gjatë katër viteve të fundit në Kosovë. Siç thashë edhe më herët. Por, për t'ua lehtësuar jetën e përditshme kosovarëve, mund dhe duhet të bëhet shumë. Dhe, që kjo të arrihet, nuk ekziston ndonjë rrugë më e shkurtër. Sepse, sado bezdisëse që mund të tingëllojë kjo, duhet të vendoset një sistem administrativ koherent dhe efikas, në mënyrë që Kosova të bëhet vend

i besueshëm për t'i joshur investimet e brendshme dhe ato të jashtme.

Donatorët e këtushëm dëshirojnë t'ju ndihmojnë, ndërsa partnerët tuaj nga UNMIK-u ju ndihmojnë t'ia arrini këtij qëllimi. Ju propozojmë që përafshisht t'i vlerësoni standardet tuaja me tonat. Ne nuk pretendojmë se ligjet tona është gjithmonë lehtë të implementohen. Por, kur theksojmë nevojën për përputhshmëri me standardet e BE-së, ne e themi këtë sepse besojmë se kjo do t'ju jap një avantazh për të qenë konkurentë, çfarë do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik, jo vetëm sepse kjo paraqet parakusht për anëtarësim eventual në Bashkësinë Evropiane.

Implementimi i reformave të ngjashme me atë që janë bërë në pjesën tjetër të rajonit do t'ju sjell më afër Evropës. Kështu, ju do të mund të përfitonit nga përparësitë e bashkëpunimit rajonal që është duke u zhvilluar në Evropën Juglindore. Shembull i qartë është Marrëveshja mbi tregtinë e lirë me Shqipërinë që UNMIK-u sapo e ka nënshkruar, nën mbrojtjen e Paktit të Stabilitetit. Pjesëmarrja në këtë rrjet marrëveshjesh do ta shtojë qasjen tuaj në treg dhe do ta bëjë Kosovën më atraktive për investuesit.

Për këtë qëllim, BE-ja, në bashkëpunim me IPVQ-të dhe UNMIK-un, ka lancuar mekanizmin SAP të evidentimit, të cilin e përmendi edhe Z. Holkeri, për t'ju rrëfjë rrugën për t'iu afruar BE-së, e cila rrugë, thënë sinjorisht, nganjëherë do të jetë e mundimshme. Kam qenë jashtëzakonisht i kënaqur kur kam dëgjuar për angazhimin personal që e ka treguar Kryeministri dhe kolegët e tij ministritë për këtë projekt. Ju e keni vërejtur qartë rëndësinë afatshkurtë dhe afatgjatë të këtij procesi, i cili njëkohësisht do t'ju ofrojë një vlerësim të asaj se ku qëndrojnë reformat në Kosovë dhe një hartë që do t'ju orientojë se kah duhet të shkoni.

Ju duhet të jeni të gatshëm, me kalimin e kohës, ky proces do të bëhet gjithnjë e më i vështirë. Siç thashë edhe më parë, nuk ekziston ndonjë shteg më i shkurtër për reforma - të njëjtat reforma demokratike, politike, ekonomike e sociale nevojiten në çdo vend tjetër, nga Vilnusi në Tiranë, nga Lublana në Sofje. Por, e tërë kjo punë e mundimshme pa dyshim do të shpaguehet, meqë duket qartë se rrjeti po zgjerohet gjithnjë e më shumë.

Më lejoni të insistojë prapë që jo vetëm ne në Evropë, por edhe partnerët e SHBA-ve, institucionet financiare ndërkombëtare dhe të gjithë donatorët tjerë, janë me ju dhe me BE-në për t'iu ofruar Kosovës mbështetje në rrugën drejt integritimit në familjen tonë.

# Gjermania angazhohet për të ardhmen e Kosovës në Evropë

*Politika e jashtme ka të bëjë me interesat kombëtare. Për këtë arsye Republika Federale e Gjermanisë është e angazhuar që para së gjithash në Kosovë të bëjë promovimin e interesave të saja nacionale. Kosova gjindet në zemër të Ballkanit. Ndërsa Ballkani është afër Gjermanisë. Për këtë arsye edhe lidhjet tona me Ballkanin janë të fuqishme dhe të shumfajshme. S'do mend se e kam fjalën këtu për lidhjet me të gjithë popujt e Ballkanit.*

**Peter Rondorf, Shefi i Zyrës gjermane për Ndërlidhje në Kosovë**

Situata në Ballkan ndikon dhe prek edhe Gjermaninë në mënyrë të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë. Punëtorët me qëndrim të përkohshëm nga ish Jugosllavia ishin grupi i dytë më i madh i punëtorëve të ardhur nga jashtë, menjëherë pas turqve. Ne dëshirojmë stabilitet dhe prosperitet në Ballkan. S'ka pikë dyshimi se nuk mund të ketë stabilitet në Ballkan nëse nuk ka stabilitet në Kosovë. Prandaj, garanca më e mirë për stabilitet është demokracia. Shoqëritë demokratike nuk luftojnë kundër njëra tjetrës. Shoqëritë demokratike i respektojnë të drejtat e njeriut dhe sundimin e së drejtës. Ato janë tolerante dhe të gatshme për integrimin e minoriteteve.

Konfliktet nuk mund të zgjidhen me armë. Forca dhe arsyet nuk janë gjithnjë me të drejtin. Për këtë arsye Gjermania dëshiron dhe angazhohet që në Ballkan të mbizotërojë demokracia. Njëherësh ne mendojmë se Kosova mund të ketë ardhmëri nëse është demokratike, mutientike dhe tolerante; nëse ka lëvizje të lirë, liri të shprehjes, liri për t'u tubuar dhe për të protestuar në mënyrë paqësore; nëse respektohet ligji dhe para-

ndalohet dhe luftohet sundimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Angazhimi i Gjermanisë është shumë i vendosur. Kështu, në përbërje të KFOR-it janë duke shërbyer 3.400 ushtarë gjermanë, të cilët ndihmojnë për të siguruar një ambient të qetë dhe të sigurt. Ata ndërtojnë ura, ata poashtu u ndihmojnë refugjatëve serb që të rivendosen. Në këtë mënyrë ata mbështesin tolerancën dhe vlerat demokratike. Treqind e gjashtëdhjetë policë dhe gjashtëdhjetë policë gjermane japin kontributin e tyre dhe e ndihmojnë luftën kundër krimit dhe njëherësh angazhohen dhe bëjnë përpjekje për t'i aftësuar kolegët e tyre kosovarë që në një të ardhme jo aq të largët t'i marrin vetë këto përgjegjësi.

Taksapaguesit gjermanë kanë dhënë afro 200 milion euro ndihmë pa kthim për rindërtimin dhe zhvillimin e ekonomisë të Kosovës. Angazhimi dhe zotimi ynë është i qëndrueshëm, prandaj ne do ta vazhdojmë këtë agazhimim. Por, ne mund të jemi të sukseshëm vetëm nëse miqtë tanë kosovar e mbajnë pjesën e tyre të përgjegjësive, që do të thotë i paguajnë tatimet, faturat e energjisë elektrike

dhe e kursejnë ujin.

UNMIK-u, KFOR-i, bashkësisia ndërkombëtare, SHBA, UE dhe Gjermania si anëtare e NATO-s, shtetet e Kuintit, Grupi i Kontaktit dhe Këshilli i Sigurimit, ne të gjithë kemi një vizion për Kosovën: Demokracia duhet të lëshojë rrënjë në Kosovë. Institucionet e Përkohshme luajnë një rol të pazëvendësueshëm në përcaktimin dhe ndërimin e kësaj ardhmërie. Tek e mbrama, të gjitha përpjekjet mund të jenë të kota, nëse nuk ka sens për përgjegjësinë nga ana e institucioneve vendore. Këtë vit kemi vërejtur një përparim në këtë drejtim. Fjala vjen, Kuvendi ka bërë një punë të mirë me krijimin dhe ndërtimin e kornizës ligjore në Kosovë. Mua më gëzon fakti se edhe Fondacionet Politike gjermane kanë dhënë kontributin e tyre për arritjen e këtij suksesi nën ombrellën e Iniciativës për Përkrahjen e Kuvendit. Njëkohësisht, mua më vjen mirë që në të ardhmen vetë Parlamenti - Bundestagu - Gjerman, do të ketë rastin që të ofrojë ndihmë të mëtejshme falë projektit të sponsorizuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim.

Angazhimi ynë është i qëndrueshëm dhe i vazh-

dueshëm, së këndejmi politika jonë është dhe mbetet: "Standartet para Statusit" dhe nuk duhet të ketë dyshime lidhur me këtë. Mirëpo, ky koncept nuk është statik dhe prandaj duhet të shihet dhe inter-pretohet në mënyrë dina-mike. Vetë fakti se UNMIK-u është duke menduar dhe diskutuar për mënyrat se si të implementohen standartet e provon këtë. Insitucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes do të jenë fuqimisht të përfshira në këtë proces. Kështu do të ketë të drejta të përbashkëta dhe përgjegjësi të përbashkëta. Dhe një ditë do të ketë edhe provim. Gjermania do të jetë me ju dhe do t'ju ndihmojë gjatë gjithë kohës!

Mirëpo, rruga nuk përfundon aty. E ardhmja e Kosovës është në Evropë, jo vetëm gjeografikisht, por edhe ekonomikisht dhe politikisht. Kosova nuk është një ishull në detin e Karibeve, prandaj sa do që shumë njerëz mund ta dëshirojnë këtë, Kosova nuk mund të bëhet pjesë e Shteteve të Bashkuara. Nëse populli i Kosovës vërtetë dëshiron që të bëhet anëtar i familjes Evropiane, atëherë duhet t'i plotësojnë kushtet e nevojshme. Kështu, do të ketë standarde të tjera për



Kosovën. Unioni Evropian në vitin 1993 në mënyrë të qartë i ka parashikuar dhe parashtruar kriteret, të cilat duhet të përmbushen nga shoqëritë dhe vendet që dëshirojnë të bëhen pjesë e këtij Unioni. Këto janë të ashtuquajturat "Kriteret e Kopenhagës", ku marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe respektimi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të minoriteteve janë nga më të rëndësishmet. Në këtë kuptim rruga e Prishtinës për në Bruksel shpie përmes Beogradit. Ardhmëria evropiane për Kosovën do të thotë se kufijtë do ta humbasin karakterin e tyre ndarës. Të gjithë njerëzit e Unionit do të jenë të lirë të vendosen kudo që dëshirojnë. Unë vërtetë shpresoj se të gjithë Kosovarët do ta përqafojnë këtë të ardhme evropiane, do ta kuptojnë dome-thënien dhe rëndësinë e saj, dhe do të punojnë me tërë energjinë e tyre për ta arritur këtë synim.

# “Ne nuk mund të jemi pasivë, por duhet të angazhohemi”

*Vesna Jovanović është anëtare e Koalicionit Kthimi (KK) në Kuvendin e Kosovës dhe e Alternativës Demokratike (AD). Ajo është anëtare e dy komisioneve - atij për Media dhe për Mbrojtje të Ambientit.*

*Ivana Marković është anëtare e Partisë Demokratike të Sërbisë (PDS) dhe e KK-së në Kuvendin e Kosovës. Ajo është anëtare e Komisionit për Kulturë, Sport dhe Rini. Në prag të sesionit parlamentar, ASI zhvilloi biseda me të dyja këto politikanë, ngase ishin fytyra të reja në “Koalicionin Kthimi”*

## Intervistë me Ivana Markovićin and Vesna Jovanovićin, Intervistën e zhvilloi Biserka Ivanović

**ASI: Çfarë është pozita juaj si femra në Kuvend?**

**Vesna:** Unë e shoh pozitën time në Kuvendin e Kosovës në radhë të parë si pjesëtare të komunitetit sërb dhe si banore të Kosovës, dhe jo si femër.

**Ivana:** Siç tha edhe Vesna, kjo ndarje nuk është e ndonjë rëndësie të veçantë. Ne para së gjithash luftojmë për interesat e komunitetit sërb.

**ASI: Me çka jeni marrë para se të filloni të merreshit me politikë?**

**Vesna:** Te vona, kam punuar si mësime në një shkollë të mesme në fshatin Partesh afër Gjilanit.

**Ivana:** Unë jam deputetja më e re në Kuvendin e Kosovës dhe është një kënaqësi e veçantë për mua që më është dhënë rasti të punoj me njerëz me aq përvojë dhe kaq të zgjuar, nga të cilët mund të mësoj shumë. Momentalisht, jam duke i përfunduar studimet në Fakultetin Juridik.

**ASI: Meqë jemi duke biseduar për punën dhe aktivitetin tuaj politik**

**në Kuvendin e Kosovës, a jeni të interesuara që të kandidoheni sërish dhe të shërbeni edhe një mandat ?**

**Vesna:** Po të ma kishit parashtruar të njëjtën pyetje para 3 muajsh, përgjigja ime do të ishte sigurisht jo. Por, tani përgjigja ime është PO, ngase unë e kam kuptuar se kjo është një “garë” prandaj, po deshet të ndryshoni diçka, atëherë duhet të merrni pjesë në te e jo të qëndroni anash.

**Ivana:** Unë mendoj se nuk duhet të rrijmë duarkryq kur përballemi me probleme të mëdha. Ne duhet të angazhohemi.

**ASI: Çfarë janë mundësitë tuaja për të pasur kontakte të vazhdueshme me elektorat tuaj, me njerëzit që votuan për ju dhe ju sollën në Kuvend?**

**Vesna:** Ne kemi grupe të ndryshme të caktut, ngaqë Ivana është një PZHV (Person i Zhvendosur brenda Vëndit), ndërsa unë jetoj në Kosovë. Edhe unë u detyrova të zhvendosem, të largohem nga Prishtina.



Mirëpo, pas dy vitesh unë u ktheva dhe tani jetoj në fshatin Partesh, në rajonin e Anamoravës. Ka shumë njerëz që kanë mbetur. Më lejoni t'a përshkruaj se si duket një ditë pune. Para disa ditësh u takova me ca fshatarë të fashit Pasjan dhe më pas udhëtova për në Podgoricë. Njerëzit janë kthyer tanimë dhe po presin që shtëpitë e tyre të rindërtohen. Unë ndejta me ta deri në orën 23:00 për t'i dëgjuar problemet dhe hallet e tyre. Katërbëdhejetë prej tyre tani për tani jetojnë në kondita të padurueshme. Për këtë arsye unë e thirra Këshilltarin Special të PSSP-së për Çështje të Kthimit,z.

Nenad Radoslavljevic, dhe së shpejti ai do të na tregojë se çfarë planifikon UNMIK-u të ndërmarrë lidhur me këtë. Posa të informohem lidhur me këtë, unë menjëherë të nesërmen do të shkoj t'i lajmëroj njerëzit se çfarë është duke ndodhur. Siç mund të shifni unë kam mjaft kontakte me njerëz.

**Ivana:** Unë kam jetuar në Ferizaj deri në vitin 1999. Tani jetoj në Vrnjaçka Banjë dhe udhëtoj rregullisht për të marrë pjesë në sesionet e Kuvendit. Të rinjtë nga qyteti im i lindjes kanë ikur në Sërbë dhe Mal të Zi, por unë ende mbaj kontakte me ta. Unë takohem si me ta, ashtu

edhe me të rinjtë që kanë mbetur këtu, si fjala vjen me ata nga Graçanica. Për mua është shumë me rëndësi që të marr opinionet e tyre rreth situatës politike në Kosovë. Të rinjtë janë të interesuar të kthehen në Kosovë. Së këndejmi, ata vetëm presin që të krijohen kushtet për kthimin e tyre. Mirëpo, kam frikën se me kalimin e kohës shumica e njerëzve po i humbin shpresat për kthim dhe janë ndërduzash se a do të kthen.

**ASI: Liderët më autoritativë shqiptarë i bënë thirrje PZHV-ve që të kthehen në Kosovë. Cili është mendimi juaj për këtë deklaratë?**

**Vesna:** Derisa po lexoja për një moment e paramendova veten në pozitën e PZHV-së. Ky veprim, thënë në përgjithësi, është i mirë-seardhur nëse vërtetë mund të realizohet. Çfarë do-methënie ka kjo? Unë mendoj se kjo do të thotë që të gjithë krerët politikë duhet t'ia sqarojnë publikisht dhe praktikisht këte popullit me një “gjuhë të thjeshtë”- përmes mediave,

përmes debateve të drejtpërdrejta në stacionet televizive. Ndërsa po lexoja pjesën ku thuhej, "Kosova është vendi juaj", unë pyesja veten - si person i zhvendosur brenda vendit, ku po kthehem unë kësh-tu? A po kthehem unë në vendin tim, apo mos vallë po kthehem në një vend tjetër? Por, unë besoj se është më mirë që tani për tani t'i lëmë këto gjëra me një anë.

**ASI: Ivana theksoi se ka mjaft njerëz nga Ferizaji me të cilët mban kontakte, dhe të cilët kanë shprehur dëshirë që të kthehen në Kosovë. A dëshironi që, edhe ju t'i ftoni miqtë, fqinjët, kolegët e studimeve dhe të punës dhe të afërmit tuaj që të kthehen në Kosovë?**

**Vesna:** Për të bërë një ftesë të këtillë duhet që njëherësh ta marrës edhe përgjegjësinë për jetën dhe ardhmërinë e atij personi. Mirëpo, unë nuk jam në gjendje që ta marr përgjegjësinë, ngase kjo nuk varet nga unë. Unë me gjithë dëshirë do t'i ftoja të gjithë që të kthehen. Por, nëse fillojnë të më pyesin, se a kanë siguri këtu? Si shkoj unë deri në Kuvend? Kush më vozit? Mua do të më duhet t'ua tregoj të vërtetën - se unë gjithnjë qarkulloj me përcjellje dhe se vozitem me makina të blinduara.

Pra, unë nuk mund t'ju garantoj atyre të gjitha ato që i kërkojnë ata - lirinë e lëvizjes, punësim dhe aktivitete për të rinjtë.

**Ivana:** Pa lirinë e lëvizjes as që mund të bëhet fjalë për diçka tjetër.

**Vesna:** Njëherësh, unë dëshiroj të shtoj me këtë rast se ne vërtetë shpresojmë që situata në Kosovë do të ndryshojë. Dhe se komuniteti ndëkombëtarë, tok me përfaqësuesit shqiptarë, do të punojnë me ne, përfaqësuesit e komunitetit serb, për përmirësimin e kushteve për kthimin e të gjithë PZHV-ve.

**ASI: Një prej mënyrave për të gjetur zgjidhje rreth kësaj çështje është që të propozohet një draft legjislativ. Nëse do të ishit në pozitë ta bënit këtë, çfarë do të propozonit dhe përse?**

**Vesna:** Në Kosovë është ende në fuqi Rezoluta 12-44, e cila garanton të drejtat e të gjithë njerëzve që jetojnë këtu. Megjithatë, unë do të propozoja që të përgatitet një draft ligj për mbrojtjen e komunitetit serb dhe komuniteteve tjera. Nuk dëshiroj të them komunitet minoritar, meqë unë këtu nuk e ndjej veten si pjesëtare të komunitetit minoritar. Një tjetër ligj që do ta propozoja është ai për mbrojtjen e grave, familjeve dhe të rinjëve,

meqë kam përsh-typpjen se këto kategori disi janë lënë anash, duke pritur që të vijin kohë më të mira.

**Ivana:** Unë do të propozoja një ligj që, do të siguronte jo vetëm lirinë e lëvizjes për të gjithë njerëzit në Kosovë, por edhe barazi për të gjithë pavarësisht nga përkatësia religjioze dhe nga dallimet tjera.

**ASI: Cilat janë propozimet tuaja përkitazi me çështjet e ambientit dhe si do t'i realizonit ju ato si anëtare e Komisionit për Ambient?**

**Vesna:** Është shumë me rëndësi që të respektohen ligjet dhe rregullat, lidhur me mbrojtjen e ambientit. Së këndejmi, është po aq me rëndësi që kujdesi për ambientin të jetë pjesë e sistemit arsimor, gjë e cila do të mundësonte që fëmijët të mësohen ta respektojnë dhe të kujdesen për ambientin ku jetojnë. Duhet të parashihen gjopa dhe ndëshkime të rënda për personat juridik dhe fizik, dhe njëherësh duhet të punësohen dhe angazhohen më shumë ekspertë, të shtohet numri i kontrollimeve për të pamundësuar dhe penguar prishjen e balancit natyror. Për fat të keq, implementimi i ligjit për mbrojtjen e ambientit është duke shkuar shumë ngadalë dhe druaj se derisa ta implementojmë ligjin në tërësi, ambienti

do të pësojë. Si anëtare e Komisionit për Mbrojtje të Ambientit unë i kam bërë propozimet e mia në draft ligj, lidhur me përgjegjësitë dhe detyrimet e atyre që e degradojnë ambientin. Edhe pse këto propozime u hodhën poshtë, ato në të vërtetë do t'i plotësonin dhe forconin rregullat, që merrren me këto probleme, e të cilat sipas mendimit tim janë mjaft të buta dhe deklarative.

**ASI: Me çfarë probleme të ambientit ballafaqohet vendi/ fshati juaj?**

**Vesna:** Pas eksodit të komunitetit tim, qytetet u shndërruan në diç për të cilën popullata serbe vetëm mund të ëndërrojë. Njerëzit që nuk u larguan jetojnë në zona rurale, të cilat nuk kanë infrastrukturë të përshtatshme. Në Anamoravë, ku jetoj unë, si edhe në pjesët tjera, nuk ka vend të caktuar për hedhjen e mbeturinave, nuk ka furnizim me ujë, kanalizim, dhe vlerat bakteriologjike të ujit të pijshëm janë në kufijtë e së lejueshmes, ndërsa në disa vend të tjera madje nuk ka as kaq. Njëherësh, ka mungesë të vazhdueshme të ujit në Mitrovicën veriore. Veç kësaj, në një studim i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, u konstatua se për shkak të ndotjes ekologjike në rajonin e Mitrovicës, Zveçanit dhe fash-

tit Malo Rudare koncentrimi i plumbit në gjak është 10 herë më i lartë se sa në Prishtinë. Seperacionet e zallit mund të hasen pothuajse çdo kund; kodrat po zhduken. Këto probleme janë të një rëndësie të veçantë për të gjithë banorët e Kosovës. Së këndejmi, kihet përshtypja se mënyra e të menduarit " jeto sot për sot dhe mos vraj mendjen për nesër" do të na hakmirret të gjithëve. Unë do t'i ftoja kolegët e mi të Komisionit për Ambient dhe Planifikim Hapësinor që ti vizitojnë vendbanimet ku jeton komuniteti serb për të parë se si ndikojnë problemet e ambientit në jetën tonë të përditshme.

**ASI: Fare në fund, a keni ndonjë porosi për lexuesit?**

**Vesna:** S'ka pikë dyshimi se unë angazhohem dhe do të vazhdoj të angazhohem për një jetë më të mirë të serbëve në Kosovë, ngase kjo përbën fundamentin e luftës politike të Kolicionit Kthimi. Meqë unë jetoj në Anamoravë, problemet dhe çështjet, të cilat i preokupojnë banorët e kësaj ane të Kosovës janë prioritet për mua dhe së këndejmi, unë nuk do rresht së mbrojturi interesat e tyre.

**Ivana:** Unë dëshiroj që të gjithë njerëzit, të cilët jetojnë në Kosovë, të jetojnë të lirë dhe pa frikë.

# Krijimi i bazës ligjore komerciale të Kosovës

*Sistemi juridik i çdo shteti pasqyron ligjet objektive të zhvillimit të shoqërisë sa i takon veçorive historike, shoqërore dhe ekonomike. Kosova për momentin, është në fazën e konsolidimit të sistemit të saj ligjor, i cili ka jo vetëm veçoritë e përbashëta me sistemet ligjore të vendeve të zhvilluara, por edhe karakteristikat e saj të veçanta. Sistemi i tanishëm ligjor në Kosovë, në të shumtën e rasteve, pasqyron sistemet ligjore të BE-së, dhe të SHBA-ve, e në veçanti legjislacionin që ka të bëjë me zhvillimin ekonomik.*

**Pirro Rexhepi Këshilltar për koordinim në Kuvendin e Kosovës**

Ishte angazhimi i përbashkët i degës ekzekutive të IPVQ-së (Institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes) dhe USAID-it që mundësuan projektimin e bazës së nevojshme ligjore, komerciale dhe fiskale, si p.sh Ligji mbi Regjistrimin e të Drejtave mbi Pasurinë e Patundshme, Ligji mbi Tokat, Ligji mbi Financat dhe Kontabilitetin, Ligji mbi Komunikacionin, Ligji për Aktivitetet e Tregtisë së Jashtme, Ligji mbi Bankrotimin. Këto janë ligje tani më kanë kaluar në Kuvend dhe kanë hyrë në fuqi pas miratimit të tyre nga e PSSP-së këtë vit. Secili nga këto ligje parashikohet se do të stimulojnë zhvillime të reja në lëmitë e tyre përkatëse si dhe të krijojnë rregull në realitetin e ri ekonomik në Kosovën e pasluftës.

Procesi i miratimit të këtyre ligjeve nuk ishte aq i lehtë, ngase pati shumë çështje dhe probleme të cilat zvarrisnin apo edhe vështirësonin miratimin e tyre. Një nga faktorët kryesor, të cilët shkaktonin zvarritje dhe vonesa ishin vërejtjet dhe kundërshtimet e UNMIK-ut përkatësi me

disa dispozita ligjore që kanë të bëjnë me kompetencat, duke pohuar se ato janë të drejta të rezervuara të PSSP-së me Kornizë Kushtetuese. Këto pohime nga UNMIK-u, në të shumtën e rasteve janë vlerësuar nga Kuvendi si të paarsyeshme dhe për këtë shkak shpeshherë janë hedhur poshtë pasi që janë shqyrtuar nga komisionet përkatëse të Kuvendit.

Megjithëse, rreth problemit të interpretimit të Kornizës Kushtetuese mes IPVQ - së dhe UNMIK-ut ka dallime të konsiderueshme, UNMIK-u megjithatë beson se interpretimi i Kornizës Kushtetuese mbetet ekskluzivisht kompetencë e PSSP-së, dhe se s'ka mjaft hapësirë për bisedime. Një faktor tjetër ngadalësues ishte edhe involvimi te vona i Zyrtarit të UNMIK-ut për ndërlikje, në procesin e ligjvënies. Sipas një marrëveshjeje në mes të UNMIK-ut dhe IPVQ-së, është paraparë që UNMIK-u t'i japë vërejtjet, komentet dhe të marrë pjesë në këtë proces gjatë kohës kur ligji ende diskutohet në nivelin qeveritar. Megjithatë



një gjë e tillë ka ndodhur shumë rrallë, për arsye se vërejtjet dhe komentet e tyre arrinin ose në kohën kur ligjet ishin dorëzuar në Kuvend, apo edhe kur komisionet parlamentare kishin përfunduar punën e tyre rreth rishqyrtimit të ligjeve.

Sido që të jetë, Qeveria dhe Kuvendi janë të përkushtuar ndaj prioriteteve të parashikuara në agjendat e tyre, më e rëndësishmja prej të cilave është krijimi i një tregu të qëndrueshëm ekonomik, i cili nis me krijimin e bazës ligjore komerciale dhe fiskale. Prandaj, puna e Qeverisë dhe Kuvendit, gjatë viteve të kaluara, por

edhe gjatë këtij viti, është dëshmuar të jetë shumë produktive gjatë miratimit të asaj që quhet 'shtylla' e ligjeve komerciale dhe fiskale.

Në shumë aspekte një prej ligjeve më të rëndësishme të aprovuara pa pikë dyshim është Ligji mbi Krijimin e Regjistrimit për të Drejtat mbi Pasurinë e Paluajtshme, të aprovuar nga Kuvendi më 12 tetor 2002, dhe të miratuar nga PSSP-ja më 20 dhjetor 2003. Krijimi i regjistrimit të të drejtave mbi pasurinë e patundshme ndërherësh mundëson edhe krijimin dhe sigurimin e të drejtave pronësore, të cilat janë në kundërshtim me sistemin e mëhershëm ku nuk ekzistonte pronësia, por vetëm 'shfrytëzuesit' e pronës, gjë e cila afër mendsh ka paraqitur një pengesë jashtëzakonisht të madhe për transaksionet financiare të pasurisë së patundshme. Implementimi i të drejtës për pasuri të patundshme në shumë aspekte paraqet një parakusht për fillimin e investimeve në Kosovë, dhe për këtë arsye, dega ekzekutive është shumë e

interesuar dhe e angazhuar rreth sigurimit të një implementimi të duhur të këtij ligji në gjashtë muajt e ardhshëm. Agjencioni Katastral i Kosovës është angazhuar që të krijojë Regjistrin mbi të drejtat për pasurinë e patundshme, ndërkaq projekti do të financohet nga Agjencioni Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar ("SIDA").

Ligji mbi Tokat i aprovuar në Kuvend është poaq i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë. Kjo për faktin se në të parashihet transferi i interesave në tokë si garanti për kredi dhe kështu krijon më tepër mundësi për biznese të vogla dhe stimulon zgjerimin e bizneseve të suksesshme. Kjo është metoda më e zakonshme e financimit të transaksioneve të pasurisë së patundshme. Huadhënësi hipotekar është pala e cila e transferon interesin në tokë. Pengmarrësi, zakonisht një institucion financiar, është dhënësi i kredisë apo i interesave të tjera në këmbim për interesin për siguri. Normalisht, një hipotekë paguhet me kiste ku përfshihet interesi dhe një pagesë në shumën kryesore të huazuar. Dështimi për t'i bërë pagesat rezultoi në ngrirjen e pasurisë së tokës. Ngrirja i mundëson pengmarrësit të paralajmërojnë dhe të shpallë se afati për pagesën e të gjitha detyrimeve hipotekare është afuar dhe se borxhi

lypsët shlyer menjëherë. Kjo pasohet nga futja e një klauzole të veçantë në hipotekë për të përshpejtuar punën. Dështimi për të paguar detyrimet hipotekare pas ngrirjes së tokës çon në ndërprerjen e interesave të sigurisë dhe në shitjen e saj në mënyrë që të paguhen detyrimet e mbetura hipotekare. Procesi i ngrirjes varet nga ligji shtetërorë dhe nga kushtet e hipotekës. Ky proces më së shpeshti realizohet përmes gjyqit. Mirëpo, duke marrë parasysh sistemin gjyqësor ekzistues të Kosovës, është vlerësuar dhe është parë e udhës që procesi i ngrirjes të mos jetë proces gjyqësorë.

Ligjet mbi Bankrotimin iu mundëson borxhlinjëve që të lirohen nga obligimet finaciare, pasi të shpërndahet pasuria së tyre, edhe nëse borxhet e tyre nuk janë shlyer në tërësi dhe së këndejmi, u mundëson atyre që të fillojnë nga e para. Bankrotimi është një dështim ekonomik dhe në pamje të parë mund të duket si një barijerë apo kërcënim ndaj zhvillimit ekonomik. Mirëpo, në shoqëritë me ekonomi të tre-gut, ai nuk konsiderohet si i tillë, ngase i mundëson një borxhliu, që nuk ka mundësi ta kthejë borxhin, ta shlyej borxhin e tij përmes shpërndarjes së aseteve ndërmjet kreditorëve të tij. Kjo shpërndarje nën mbikëqyrje njëherësh mundëson që interesat e të gjithë

kreditorëve të trajtohen në një mënyrë dhe masë të barabartë. Disa procedura bankrotuese lejojnë dhe mundësojnë që borxhlinë të vazhdojnë të merren me biznes edhe më tutje, duke i shfrytëzuar të ardhurat e gjeneruara për t'i shlyer borxhet e tij/saj, mirëpo qëllimi kryesor i Ligjeve mbi Tregtinë me Jashtë zakonisht ka të bëjë me transaksionin e mallrave ose shërbimeve, të zhvillohen jashtë kufinjëve të vendit. Ligji parandalon transaksionet e parregullta për eksportim, vendos një sistem të transaksioneve për eksport dhe import dhe së këndejmi ka për qëllim zhvillimin e një tregtie të mirëfillët dhe të shëndoshë me jashtë. Ligji për tregti me jashtë i Kosovës është në përputhshmëri të plotë me kërkesat e Organizatës Botërore për Tregti.

Telekomunikacioni është një fushë e cila po i tërheqë gjithnjë e më tepër investimet, sidomos për shkak të rritjes së sektorit të teknologjisë në tregun e ekonomisë globale. Ligji Kosovari i Telekomunikacionit do të mundësojë konkurrencën në mënyrë të natyrshme, për shërbuesit e tjerë që t'i përmbështojnë shërbimet për konsumatorë në këtë sektor.

Sot ambienti i biznesit në Kosovë, i shëmbëllen një ambienti që është duke lulëzuar. Siç u theksua edhe

më herët "shtylla" e legjislacionit komercial dhe fiskal tanimë është miratuar dhe është duke u zbatuar, por ligjvënësit ende përballen me sfida. Legjislacioni fiskal dhe komercial është një fushë në të cilën ligjet janë duke u krijuar dhe ndryshuar vazhdimisht dhe ku ligjet duhet të jenë në përputhshëri me standardet dhe praktikatat ndërkombëtare. Edhe pse ligjet e tanishme në Kosovë janë duke u implementuar, megjithatë ende ekziston një zbrastësirë e madhe në legjislacionin komercial dhe fiskal, i cili rregullon sferat siç janë taksat për pronën e paluajtshme, konkurrencën, themelimin dhe funksionimin e ndërrmarjeve dhe të drejtat për pronësi intelektuale, etj.

Pavarësisht prej kësaj, Qeveria është e gatshme që me ndihmën e ekspertëve të USAID-it dhe EAR-it të punojë në hartimin e ligjeve tjera të nevojshme për këtë sferë. Ndonëse kjo është një çështje mjaft e komplikuar, para së gjithash për shkak paqartësive përkitazi me të drejtat dhe autorizimet e transferuara dhe të rezervuara në relacionin UN- MIK- Qeveri e Kosovës, mund të thuhet se ende ekziston dëshira dhe gatishmëria e tyre për t'i zgjidhur këto probleme, duke i thjeshtuar ato dhe duke e hapur rrugën për përshpejtimin e legjislacionit të ardhshëm.

## vijimi i fq. 2

*Dua ta them një fjalë të fundit, një fjalë të fundit mbi atë se kah unë mendoj se jemi duke shkuar dhe çfarë kërkohet për t'u ballafaquar me sfidat që na presin. Kur u takova më herët me ministrat tuaj - po qëndroja ulur pranë mikut dhe kolegut tim Nikolaus Lambsdorf, djalit të liderit të madh politik gjerman dhe burrështetasit, të cilin e njoh shumë mirë - unë ia përkujtova Kryeministrit dhe kolegëve të tij se çfarë është BE-ja në esencë. BE-ja është shembulli më i mirë i institucionalizuar i pajtimit historik. Babai i gruas sime është vrarë mu para përfundimit të luftës së fundit, ndërsa në kolegjin e tij të vjetër në Universitetin e Kembrixhit është ngritur një pllakë përkujtimore për të gjithë studentët e atij koleji, të cilat kanë humbur jetën gjatë dy luftërave botërore. Por, emrat që përfshihen në këtë pllakë nuk kanë të ndalur. Këta emra janë, natyrisht, kryesisht britanëzë, por në mesin e tyre mund të gjinden edhe emra gjermanë. Britanëzë dhe gjermanë që kishin studiuar së bashku e që vdiqën duke shtënë në njëri tjetrin. Pse? Për shkak të mënyrës më të vrazhdë dhe më violente të shprehjes së nacionalizmit. BE-ja është themeluar që të parandalohet që kjo mos të ndodhë më kurrë. Është pra një union i grupeve të vogla, që janë përpjekur të gjejnë mënyrën që përmes zemërgjërësise dhe gjenerozitetit të shpirtit t'ua sigurojnë qytetarëve të tyre një të ardhme në paqë. Prandaj, mos u befasoni kur këtu në Kosovë, në Serbi apo diku tjetër të na dëgjoni duke folur ashtu siç flasim për pajtimin, për tmerret e dhunës etnike apo për urrjetjen e konfliktin etnik. Ju këtu në Kosovë, keni shanse reale që të korrni sukses, meqë bashkësia ndërkombëtare dëshiron që ju me çdo kusht t'ia arrini këtij qëllimi. Juve ju është ofruar rasti që të dëshmoni para mbarë botës se keni qenë të aftë t'i varrosni armiqësitë e vjetra dhe të krijoni një të ardhme, në të cilën ka drejtësi për të gjithë, pavarësisht nga përkatësia etnike apo fetare, një të ardhme që ofron respekt të barabartë për çdokënd, pavarësisht nga bindjet e tyre fetare apo prejardhja e tyre familjare. Unë shpresoj shumë se ju jeni të aftë që t'i përvisheni një sfide të tillë. Është avanturë jashtëzakonisht e madhe, por edhe një arsye tjetër pse në mesin tonë ka shumë njerëz që merren me politikë, e cila shpesh kritikohet, sepse kjo duhet të jetë avanturë e ndershme, siç dëshmoi edhe Ana Lindh në jetën e saj të shkurtë politike. Unë shpresoj se ju mund të siguroheni që Kosova të mund të përballlet me sfidën që e pret, e që është mjaft e ndershme, dhe në atë mënyrë që ua mundëson bijve dhe bijave tuaja ta kenë një të ardhme shumë të mirë, një shoqëri shumë më të mirë për jetë se shoqëria të cilës ju është dashur t'i rezistoni.*

# Ligji mbi regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë

*Për çdo vend dhe çdo popull regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është i një interesi të veçantë. Qeveria e Kosovës, që nga fillimi i punës së saj, nxjerrjen e Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave e ka konsideruar si çështje shumë të rëndësishme. Me këtë ligj sigurohet baza juridike për zhvillimin e procesit të regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë. Përmes këtij regjistrimi, do të dalin në dritë informata mbi strukturën demografike dhe karakteristikat tjera shoqërore e ekonomike të popullsisë së Kosovës. Të dhëna tjera që mund të grumbullohen nga ky regjistrim përfshijnë numrin e përgjithshëm të popullsisë, shpërndarjen territoriale, strukturën e vendbanimeve dhe ndërtesave, si dhe standardet aktuale të jetesës.*

**Dr.sc.Azem Hajdari, Koordinator në Zyrën Ligjore të Kryeministrit dhe mësimdhënës i lëndës E Drejta e Procedurës Penale në Fakultetin Juridik të Univeristetit të Tetovës.**

Qeveria e Kosovës, si pjesë e programit të saj dhe me kërkesën e Ministrisë së Shërbimeve Publike, kah fundi i vitit 2002, ka aprovuar nevojën për iniciimin e propozimit të këtij projektligji. Pas kësaj, Kryeministri vendosi t'ia caktojë për detyrë Sekretarit të tij të Përhershëm që në koordinim me Sekretarin e Përhershëm të Ministrisë së Shërbimeve Publike, të fillojë përgatitjen e këtij ligji. U emërua një grup punues, që përbëhej nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe nga përfaqësues të UNMIK-ut, për ta filluar procedurën e hartimit. Ky grup, pas një pune të mundimshme, e përgatiti draftin e parë të këtij projektligji, të cilin Ministria e Shërbimeve Publike ia dërgoi Qeverisë. Qeveria këtë ligj e ka miratuar në mbledhjen e saj të mbajtur me datën 26 mars 2003. Ligji në fjalë i është proceduar Kuvendit të Kosovës për aprovim me datën 15 prill 2003. Me rastin e shqyrtimit të dytë

të këtij ligji, në qershor të këtij viti, u aprovuan 27 amendamente shtesë, të cilat e bëjnë këtë ligj më funksional.

Po në muajin qershor, grupi parlamentar "Kthimi" i ka parashtruar mocion Kuvendit të Kosovës lidhur këtë ligj, në të cilin thuhej se ky ligj cenon interesat dhe pengon mundësitë e komunitetit serb për ruajtjen identitetit e tyre etnik. Në mocion theksohet se regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është shumë i disfavorshëm dhe i papërshtatshëm për serbët ngase një numër i madh i pjesëtarëve të këtij komuniteti ndodhet jashtë vendit dhe se në Kosovë akoma nuk ka liri të plotë qarkullimi. Së këndejmi, regjistrimi nuk mund të jetë real.

Në këtë kuptim, Kuvendi i Kosovës, është në vazhdim të përpjekjeve për ta formuar një komision, ku do të ftoheshin përfaqësuesit e Qeverisë, ata të grupit parlamentar "Kthimi" dhe të

UNMIK-ut dhe ku do të ballafaqoheshin argumentet dhe kundërgarmentet e tyre. Pavarësisht nga ajo se cili do të jetë rezultati i punës së këtij komisioni (nuk është akoma e qartë se a do të formohet një komision i tillë), rezultati i arritur do të jetë sërish çështje që do të debatohet në Kuvend.

Ligji për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave përfshin gjashtë kapituj dhe dispozita mbi: datën e regjistrimit; Komisionin Qendror të Regjistrimit; Entin Statistikor të Kosovës dhe organet komunale të regjistrimit; përgjegjësitë e Agjencionit Kadastral të Kosovës, administratën lokale dhe komunale; qendrën kryesore të përpunimit të të dhënave, disa dispozita mbi ndalimin e grumbullimit të të dhënave të ngjashme, etj.

Me poshtë janë rradhitur një numër çështjesh që kanë të bëjnë me Ligjin mbi regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave:

- Vështruar esencën dhe përmbajtjen, mund të vlerësohet se, Ligji për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është unifikuar dhe standardizuar me ligjet më të përparuara të shteteve bashkëkohore.

- Ligji në fjalë arrinë që me kompetencë t'i adresojë bartësit e përgjegjësive dhe ti përkufizojë qartë kompetencat e secilit prej tyre. Kështu, ligji përcakton se autoritet i regjistrimit është Enti Statistikor i Kosovës, të cilit i është vënë në barrë organizimi dhe realizimi i regjistrimit.

- Konsiderojmë se ky ligj ofron mundësi që, për herë të parë pas 22 vjetësh, të kemi një regjistrim objektiv, valid e të qëndrueshëm të popullsisë dhe pronës. Ai nuk përmban asnjë dispozitë që kufizon të drejtën e banorëve të Kosovës për t'u përfshirë në regjistrim. Përkundrazi, ofron mundësi që regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave të jetë sa më

gjithëpërfshirës, përfshirë këtu edhe të zhvendosurit. Në këtë drejtim, me nenin 17, ligji e obligon Entin Statistikor të Kosovës që paraprakisht ta zhvillojë një fushatë të gjerë të informimit, gjatë së cilës do të bëhen të qarta qëllimet, procedurat dhe obligimet përkatëse të bartësve të regjistrimit.

- Me regjistrimin, që sipas këtij ligji parashikohet të zhvillohet në gjashtëmuojin e parë të vitit 2004, do të vërtetohet se sa banorë i ka Kosova, cila është struktura e popullsisë sipas përkatësisë kombëtare, sociale etj, cila është gjendja faktike në lidhje me pronat (numri, pronësia, etj.) dhe sa qëndrojnë deklaratimet serbe në lidhje me këtë çështje.

Duke pasur parasysh këto fakte, PSSP-ja, në afatin më të shkurtër të mundshëm, do ta fuqizojë këtë ligj, me çka do të hapet rruga që regjistrimi i popullsisë të bëhet në afatin e përcaktuar.



## Bisedimet e të barabartëve

*Bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për çështje praktike, konsiderohen shumë të nevojshme, si për këto dy vende, ashtu edhe për rajonin. Përfundimi me sukses i tyre do të thotë pranim i realitetit të Kosovës dhe respektim i këtij realiteti, i cili tash e katër vjet po funksionon duke reflektuar normalitet, paqe dhe siguri.*

**Rramush Tahiri, Këshilltar Politik i Kryetarit të Kuvendit të Kosovës**

Institucionet e Kosovës, të gjitha, janë deklaruar se janë të gatshme të nisin procesin e bisedimeve dhe se vetëm presin thirrjen nga institucionet përkatëse ndërkombëtare. Kosova nuk paraqet parakushte as nuk kushtëzon agjendën e bisedimeve, vetëm dëshiron që bisedimet të mos jenë deklarative, por të zbatueshme dhe kërkon që delegacionet në bisedime të jenë të nomenklaturës së njëjtë dhe plotësisht të barabarta në të dy anët e tavolinës. Zakonisht bisedimet e filla zhvillohen në nivel të Qeverive përkatësisht në nivel të ministrive, e në konkretizim e hartim të dokumenteve marrin pjesë drejtoritë përkatëse, që profesionalisht e institucionalisht mirren me këto çështje. Për të qenë të vlefshme marrëveshjet, ato duhet edhe të ratifikohen në parlamentet e të dyja vendeve...

Pse është i rëndësishëm dialogu me Serbinë, për Kosovën? Në rend të parë është shprehje e vullnetit të mirë për zgjidhje të çështjeve që janë në interes të qytetarëve të dy vendeve, që kishin një të kaluar

të keqe në marrëdhëniet ndërmjet veti. Veç kësaj, do të ndikonte në normalizim dhe relaksim të raporteve në rajon, dhe në simbolikën se mund të jetojnë e punojnë së bashku, në rrugën drejtë integritimeve evropiane. Edhe Serbia edhe Kosova e kanë problemin e personave të zhdukur, të dyja e kanë të përbashkët problemin e personave të zhvendosur, të dyja i kanë problemet e sigurisë dhe të luftimit të kriminalitetit të dyja e kanë çështjen e suksesionit etj. Kosova është e interesuar që ti kthehen librat e kadastarës dhe të amzës, të marrë nga

regjimi i Millosheviqit gjatë tërheqjes nga Kosova. Këta libra bie fjala, iu këthyen nga Serbia, Kroacisë për disa rajone të saja, tek para pak kohësh, edhe pse lufta ka mbaruar para një dekade.

Çka dëshmon Serbia me hyrjen në bisedime me Kosovën? Në rend të parë se e pranon realitetin e ri të Kosovës, se shprehë vullnetin që të mos identifikohet me regjimin e Millosheviqit dhe se nuk don të jetë ruajtse e veprave të tij, në rastin. Gjithashtu, relakson marrëdhëniet siguron komunikim e qar-

kullim të lirë të të gjithë qytetarëve, si dhe ndihmon që statusi përfundimtar i Kosovës të zgjidhet me marrëveshje dhe në interes të dy vendeve.

Cilat janë pengesat për dialog sot? Në rend të parë e kaluara dhe pasojat e saja që nuk lënë ndonjëherë që të shihet e ardhmja. Çasja që përmes bisedimeve të prejudikohet statusi final i Kosovës. Pengesë është edhe caktimi i parametrave të bisedimeve dhe nivelit të delegacioneve. Serbia ka krijuar një Këshill për Kosovën dhe të gjitha kontaktet edhe me UNMIK-un edhe me Kosovën (ajo thotë me shqiptarët e Kosovës) dëshiron ti reduktojë në bisedimet me këtë këshill, dhe në kuadër të mandatit të paracaktuar të tij. Serbia edhe tash e katër vjet nuk i pranon dokumentat e UNMIK-ut, pasaportat dhe lejet e njoftimit për qytetarët e Kosovës. Gjithashtu nuk i pranon institucionet e Kosovës të dala nga zgjedhjet e lira dhe të vëzhguara ndërkombëtarisht. Kuvendi i Serbisë ka një Rezolutë, ku nuk e pranon as Kornizën Kushtetuese të Kosovës...

Nga faktori ndërkombëtar mbetet të jetë i vendosur dhe me kombinim masash, të shtyjë palët drejtë dialogut, e më vonë të respektimit të marrëveshjeve të nëshkruara. UNMIK-u në këtë proces nuk mund të jetë ndërmjetësues pasi ai është palë e Kosovës dhe prandaj së bashku me institucionet e zgjedhura përfaqëson Kosovën brenda dhe jashtë.

Ndërmjetës mund dhe duhet të jenë BE-ja dhe SHBA-të, për shkak të rolit dhe respektit që kanë në Kosovë, autoritetit dhe mekanizmave që mundësojnë implementimin dhe garantimin e marrëveshjeve. Vendi i negociatave vetëm në fillim mund të jetë neutral e më vonë mund të zhvillohen rradhazi në Prishtinë dhe në Beograd. Marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, do të ketë herët a vonë, sa më herët aq më mirë, përndryshe jeta e ka rrjedhën e saj dhe proceset e kanë kahjen e vetë të natyrshme, që nuk duhet dhe nuk mund të ndalet, e që janë në harmoni me vullnetin e popullit të shprehur lirshëm.



# KUVENDI - PASQYRË E VENDIT

*Tani, në vitin e dytë të jetës së tyre, puna e Kuvendit dhe institucioneve tjera të Kosovës, vlerësohet në mënyrë të ndryshme e herë herë krejt të kundërt. E vërteta qëndron diku në mes. Institucionet e reja kosovare nuk janë as dështim i plotë, siç thonë nihilistët, as më të sukseshmet në regjion, siç thonë projeksionistët iluzionistë. Institucionete e reja të Kosovës janë në udhëkryq dhe para sprovave të rënda, siç është edhe vetë Kosova.*

## Hydajet HYSENI

Suksese ka dhe ato duhet njohur e popullarizuar. Vetë themelimi i Kuvendit dhe Qeverisë së koalicionit mund të konsiderohet si sukses. Falë përpjekjeve vetanake dhe ndihmës së drejtpërdrejtë dhe mbështetjes nga Bashkësia Ndërkombëtare, u organizuan zgjedhjet qendrore dhe ato komunale, të cilat ndër-kombëtarisht u njohën si të drejta dhe të sukseshme.

Është krijuar një sistem i ri institucional, i cili po kompletohet vazhdimisht dhe përkundër dobësive dhe mangësive, megjithatë funksionon në mënyrë të qëndrueshme. Kuvendi i Kosovës, që poashtu ka përfaqësim favorizues për bashkësitë minoritare, ka zhvilluar një veprimtari të vazhdueshme e të pandërprerë ligjvënëse dhe politikëndërtuese, marrë në përgjithësi, pa probleme e përplasje të mëdha. Deputetët e Kuvendit dhe stafi administrativ i Kuvendit kanë marrë pjesë në një varg seminaresh dhe sessionesh trajnimit, me përkrahjen e kuvendeve të



Hydajet Hyseni

vendëve të ndryshme, fondacioneve e institucioneve tjera, përfshirë NDI, fondacionin Westminster dhe Friedrich Ebert Stiftung. Falë mbështetjes së këtyre kuvendeve dhe përkrahjes së Inicativës për mbështetje Kuvendit të Kosovës (ASI), janë vendosur kontakte ndërparlamentare me disa vende dhe janë organizuar vizita e kontakte të ndërsjella pune, që janë vlerësuar si tejet të dobishme.

Pa i mohuar, as zvogëluar, të arriturat, megjithatë mund të thuhet me plotë gojë se organizimi dhe efektiviteti i institucioneve tona lë shumë për të dëshiruar. Po lëvizet, por tepër ngadalë dhe jo gjithmonë në drejtimin e duhur. Rezultatet e shënuara janë në shpërputhje të konsiderueshme jo vetëm me atë që dëshirohet e synohet, por edhe me mundësitë objektive të strukturave

institucionale të Kosovës. E vetmja mënyrë për t'i pamundësuar politikat jashtinstitucionale është angazhimi me përkushtim, me përgjegjësi dhe rrjedhimisht me rezultate të institucioneve.

Kuvendi i Kosovës, ashtu si edhe institucionet tjera nuk ka arritur as përafërsisht të anagazhojë potencialin e tyre kreative e veprues, nuk ka arritur të plotësojë as hapësirën e vogël e të kufizuar që i është lënë dhe as të shfrytëzojë përparësitë ekzistuese, pa lëre t' i zgjerojë e avansojë ato. Kjo ka dëmtuar dhe vazhdon të dëmtojë seriozisht proceset në Kosovë dhe rrjedhimisht ka ulur kredibilitetin e institucioneve kosovare në sytë e opinionit kosovar. Kosova, tashmë ka një përvojë të hidhur që do të duhej të ishte kthyer në mësim për pasojat që prodhon lejimi i diskreditimit të institucioneve demokratike, në sytë e opinionit të pakënaqur.

Kuvendi i Kosovës dhe institucionet e reja demok-

ratike në Kosovë patën një një lindje, të vështirë dhe të pazakonshme. Kushtet specifike në të cilat funksionojnë, pengojë funksionimin e dëshiruar të Qeverisë dhe së këndejmi, kufizojnë mundësinë për arritjen e rezultateve të mundshme dhe të dëshirueshme. Këto kushte, apo kufizime, janë: sistemi joadekuat zgjedhor; funksionalizimi i vonuar i Kuvendit, si dhe rekrutimi arbitrar dhe jo transparent i administratës së Kuvendit dhe strukturave drejtuese e menaxhuese. Veç kësaj, mungesa e kushteve elementare për një funksionim sa do pak normal buron edhe nga mungesa e përvojës demokratike, inercia e përvojës së keqe kuazi-parlamentare dhe jofunksionale, që për pasojë ka arbitratritetin e shpeshhtë procedural dhe ngulfatjen e iniciativës së deputetëve. Kjo, më pas, ka shkaktuar influencime joadequate, destruktive dhe jodemokratike të faktorëve të jashtëm dhe përvojave të ndryshme, të cilat shpesh janë inkompatibile me ku-

shtet specifike kosovare. Për më tepër, ekziston një obstrukcion i vazhdueshëm dhe instrumentalizim i një pjese të popullatës nga disa qarqe që nuk ia duan të mirën Kosovës dhe njerëzve të saj. Një pjesë e shkaqeve, të mos efikasitetit të dëshiruar të Kuvendit nuk mund të ndryshohen lehtë e shpejt. Por, janë disa penegesa që mund të konsiderohen subjektive dhe si të tilla ato mund dhe duhet të mënjanohen.

Ato, mendoj edhe do të jenë sfidat me të cilat do të përballët Kuvendi i Kosovës në sesionin vje-shtor pjesën e mbetur të kësaj legjislature.

Theksojmë vetëm disa prej tyre:

- Definimi i statusit të deputetit, mandatit dhe imunitetit të tij;
- Krijimi i kushteve të nevojshme për punë normale të deputetëve, kryesive të grupeve, komisioneve dhe administratës, duke përfshirë këtu veçanërisht zyrat, paisjet, shërbimet, stafin, transportin, parkingun dhe lehtësitë tjera të nevojshme;
- Funkcionalizimi i plotë i Kryesisë së Kuvendit, ndërtimi me rregullore

të posaçme i raporteve adekuate Kryesi - Kryetar i Kuvendit, Kryesi - Grupe parlamentare, Kryesi - Komisione parlamentare dhe Kryesi - administratë e Kuvendit;

- Ndërtimi i raporteve funksionale e të rregullta midis Kryesisë dhe Sekretarisë së Kuvendit dhe në këtë mënyrë dhe sigurimi i parakushteve për rregullsi, transparencë dhe kontroll demokratike në çështjen e ndërtimit të buxhetit dhe menaxhimit të përgjithshëm të Kuvendit si dhe procesit të rekrutimit të personelit dhe ndërtimit të strukturave administrative të Kuvendit;
- Finalizimi i procesit të stërgjatur të plotësimeve dhe ndryshimeve të Rregullores së Kuvendit dhe përgjithësisht rregullativës së funksionimit të Kuvendit;
- Krijimi i kushteve për debat të lirë dhe tolerant parlamentar, posaçërisht sa u përket pyetjeve dhe interpelancave parlamentare;
- Komunikime të rregullta midis deputetëve dhe përfaqësuesve të Kuvendit me qytetarët dhe shoqërinë civile;
- Shtimi i bashkëpunimit me parlamentet e vendeve tjera dhe intergrimi i Ku-

vendit të Kosovës në strukturat parlamentare ndërkombëtare dhe, në këtë kontekst, formimi i një shërbimi për bashkëpunim ndërkombëtar;

- Përsheptimi i aktiviteteve të ligjvënjes dhe përqëndrimi në përgatitjen e pakos kryesore të sistemit të ligjvënjes dhe, njëkohësisht, rafinimi i procedurave të ligjvënjes, posaçërisht procedurave të shqyrtimit dhe votimit të amendamenteve, revizimit të teksteve dhe sigurimit të teksit final dhe origjinal të një ligji të aprovuar;
- Sigurimi i marrëdhënieve funksionale midis Kuvendit dhe Qeverisë dhe, në këtë kuadër, koordinimi i përgatitjes së kalendarit të aktiviteteve të Kuvendit, e veçanërisht të aktiviteteve të ligjvënjes;
- Qartësimi dhe funksionalizimi i raporteve midis Kuvendit dhe Kryetarit të Kosovës;
- Korrigjimi i mospërputhjeve dhe të metave të dukshme të sistemit aktual të zgjedhjeve;
- Qartësimi dhe saktësimi i raporteve funksionale dhe procedurale midis Kuvendit dhe PSSP-së përmes një bashkëpunimi komplementar të afërt dhe të rregullt, si dhe definimi i qartë dhe inter-

pretimi progresiv i të ashtuquajturave kompetenca të rezervuara.

Kuvendi i Kosovës dhe legjislatura e saj e parë ka misionin historik që duke ndërtuar dhe funksionalizuar vetveten, të ngre dhe të funksionalizojë edhe strukturat tjera institucionale demokratike të Kosovës së re, të plotësojë vakumin e rrezikshëm institucional dhe ligjor, dhe

në këtë mënyrë të krijojë parakushtet e nevojshme për normalizimin e plotë të gjendjes së përgjithshme në Kosovë, për profilizimin dhe ndërtimin e një të ardhme të lirë, të pavarur e demokratike për Kosovën, dhe mbi këtë bazë për ndërtimin e një shoqërie të re vërtetë demokratike, pluraliste, tolerante, prosperuese dhe evropiane, në interes të të gjitha komuniteteve dhe qytetarëve të Kosovës.



## Përmirësime të vazhdueshme në punën e komisioneve

*Procesi legjislativ demokratik që sjell ligje, të cilat merren me nevojat e njerëzve dhe me zgjidhjen e tyre kërkon një sërë aktivitetesh. Në radhë të parë, lypset që parlamentarët të jenë në gjendje të involvohen dhe të angazhohen në mënyrë aktive në analiza thelbësore rreth çështjeve që debatohen me kolegët e tyre dhe të hyjnë në dialog me qytetarët. Veç kësaj, nevojiten komisione parlamentare me staf ndihmës që janë gjendje të shqyrtojnë projekt-ligjet. Njëherësh, nevojiten grupe politike të organizuara. Dhe çfarë është më e rëndësishmja, nevojitet një koordinim më efektiv në mes të gjitha këtyre elementeve.*

### Heather Kashner, Drejtor i IDK-së për Kosovën

Procesi legjislativ demokratik që sjell ligje, të cilat merren me nevojat e njerëzve dhe me zgjidhjen e tyre kërkon një sërë aktivitetesh. Në radhë të parë, lypset që parlamentarët të jenë në gjendje të involvohen dhe të angazhohen në mënyrë aktive në analiza thelbësore rreth çështjeve që debatohen me kolegët e tyre dhe të hyjnë në dialog me qytetarët. Veç kësaj, nevojiten komisione parlamentare me staf ndihmës që janë gjendje të shqyrtojnë projekt-ligjet. Njëherësh, nevojiten grupe politike të organizuara. Dhe çfarë është më e rëndësishmja, nevojitet një koordinim më efektiv në mes të gjitha këtyre elementeve.

Përkundër kritikave të drejtuara në adresë të Kuvendi i Kosovës, Kuvendi ka bërë përpjekje të dukshme dhe të njëmendëta drejt arritjes së këtyre objektivave në punën e vet ditore. Kështu, deputetët dhe stafi i Kuvendit kanë krijuar një rutinë dhe së këndejmi, cilësia dhe efikasiteti i përgjithshëm i këtij institucionit të rëndësishëm është ka shënuar përpjekje të dukshme. Mirëpo, akoma mbetet shumë për t'u bërë. Vlerësimi dhe raporti i

këtyre ditëve nga ana e IDK-së ka për qëllim të sjellë ca vështrime rreth Kuvendit dhe organizatave, të cilat e mbështesin atë për të vazhduar me këtë përpjekje, veçanërisht në lëminë e forcimit të komisioneve.

Puna e komisioneve do të mund të jetë më efikase kur të zgjedhen disa çështje teknike. Kjo nënkupton gjetjen dhe përcaktimin e sallave të komisioneve, punësimin dhe kompletimin e stafit, dhe mirëmbajtjen e arkivave të dokumenteve. Për fat të mirë, UNDP-ja është duke bërë përpjekje që të mundësojë dhe sigurojë mirëmbajtjen e arkivave të dokumenteve përmes projektit SPEAK.

Përkundër sfidave teknike që kanë ngelur ka edhe disa përmirësime që kanë ndihmuar në funksionimin më të mirë të Kuvendit.

- Grupet parlamentare kanë tani zyret e veta, gjë e cila u ka mundësuar grupeve parlamentare të mbledhen më shpesh. Tani për tani, ata takohen para mbledhjeve plenare dhe disa prej tyre takohen edhe një ditë tjetër për të diskutuar rreth punëve dhe obligimeve të krerëve partiakë.

- Rishikimi i Rregullave të Procedurës, i ka dhënë mandatin dhe ua ka bërë të mundur komisioneve që t'i shqyrtojnë dhe adresojnë kërkesat e deputetëve.

- Marrëdhëniet me ministrinë janë përmirësuar në shumicën e komisioneve. Kështu, kontaktet me ministrinë janë bërë pjesë e funksionimit normal dhe të rregullt për shumicën e komisioneve, përfshirë këtu edhe shkëmbimin dhe komunikimin me shkrim, kur është fjala për ligjet e hartuara nga Qeveria dhe për praninë e përfaqësuesve të ministrisë në mbledhjet e komisioneve.

- Deputetët tani marrin për diem për udhëtimet e tyre dhe për pjesëmarrjen në mbledhjet e komisioneve, gjë që ka përmirësuar vijimin në mbledhjet e komisioneve.

- OSBE-ja ka angazhuar një përkthyes më orar të plotë për të përmirësuar komunikimin në mes të stafit vendorë dhe ndërkombëtarë në Kuvend.

Një numër i komisioneve është duke punuar dhe funksionuar mirë dhe në mënyrë shumë aktive. Ata

bashkëpunojnë ngushtë me ekspertët nga organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare dhe i ftojnë ata rregullisht në mbledhje të komisioneve. Deri tani janë mbajtur tri dëgjime publike për të mbledhur informacione për ndonjë projekt ligj, apo edhe për të hulumtuar dhe diskutuar mbi ndonjë problem. Është zgjuar interesim në mesin e komisioneve për t'i shfrytëzuar dëgjimet publike si mjet për grumbullimin e informacioneve përkatëse dhe për shqyrtimin e projektligjeve, duke kryer punën e tyre në të njëjtën kohë në mënyrë më transparente dhe më të hapur ndaj opinionit.

Një numër i komisioneve ka bërë edhe ca vizita në terren për t'u njohur më mirë dhe më për së afërmi rreth ndonjë problemi të caktuar. Këto vizita ndodhin kryesisht kur komisionet duhet të shqyrtojnë një projekt ligj, ndërsa herë herë vizitat vijnë edhe si reagim ndaj peticioneve të drejtpërdrejta të qytetarëve dhe japin rezultate konkrete.

Komisionet kanë filluar të kuptojnë se hulumtimi rreth çështjeve dhe problemeve të

rëndësishme, dhe dhënia e rekomandimeve përmes raportimit në ministrinë përkatëse apo edhe në UNMIK është detyrë dhe mandat i tyre. Këso masa merren zakonisht me kërkesën e Kuvendit. Disa nga ato raste janë, për shembull:

o Komisioni për Shërbime Publike ka përgatitur një raport mbi situatën rreth dokumenteve personale të pasurisë dhe të dhënave mbi qytetarët e Kosovës (p.sh. lindja, vdekja, vërtetimet e kurorëzimit, patentët e shoferit etj).

o Komisioni për Tregti dhe Industri ka raportuar mbi situatën mbi furnizimin me energji elektrike në Kosovë.

Mirëpo, komisionet dhe Kuvendi në përgjithësi kanë ende punë për të bërë. Ndiheja e vazhdueshme për anëtarët e komisioneve dhe stafin është e domosdoshme për të siguruar që këto punë dhe rezultate të shkëlqyeshme të bëhen pjesë normale dhe e rregullt e punës. Një shqetësim tjetër rreth funksionimit të punës së Kuvendit, që u indentifikua falë përmirësimit të punës së komisioneve dhe diskutimit të raporteve të komision-

neve, është edhe koordinimi me grupet parlamentare. Grupet Parlamentare kanë shprehur mospajtim me konkluzionet e raporteve, që janë arritur në marrëveshje mes komisioneve ku kanë qenë të përfaqësuara të gjitha grupet parlamentare. Natyrisht, se ndodhë dhe është normale që anëtarët të kenë mospajtime rreth konkluzave të komisioneve, por që të tëra grupet parlamentare të mos pajtohen me komisionin, kjo tregon dhe dëshmon se mungon koordinimi mes anëtarëve të komisioneve dhe krerëve të partive të tyre rreth qëndrimeve që duhet mbajtur mbi çështje të caktuara.

Sido që të jetë, është me interes që grupet parlamentare vazhdojnë të përmirësojnë funksionimin dhe koordinimin e tyre. Për më tepër, ky proces do të përmirësohet ende në sajë të punës mbështetëse të organizatave që punojnë me deputetët e Kuvendit dhe partitë, për t'u ndihmuar atyre që t'i forcojnë lidhjet në mes veti dhe të vazhdojnë të zhvillojnë politikat e tyre. Të dy këto përpjekje do të forcojnë punën e komisioneve dhe punën e tërë Kuvendit.

Pas së gjithash, vlerësimi i bërë nga ana e IDK-së ka ndriçuar shumë zhvillime pozitive në aktivitetet e procesit legjislativ demokratik, që sjellin ligje, të cilat u përgjigjen më mirë nevojave të qytetarëve të Kosovës.

## Resoluta e Kuvendit i jep vull procesit të kthimit të të zhvendosurve

*Duke marrë për bazë letrën e hapur përmes së cilës inkurajohej kthimi i PZHV-ve dhe refugjatëve, e cila ishte nënshkruar nga të gjithë liderët kryesorë shqiptarë dhe liderët tjerë të minoriteteve, Kuvendi i Kosovës, më 10 korrik 2003, zhvilloi një debat zyrtar lidhur me procesin e kthimit të të zhvendosurve-debati i dytë me radhë i këtij lloji gjatë dy viteve të fundit. Debatit rezultoi në nëntë rekomandime, të cilat, duke iu referuar deklaratës së Kuvendit të vitit të kaluar, rikonfirmoi mbështetjen e IPV-ve për të drejtën e të gjithë PZHV-ve dhe refugjatëve për t'u kthyer në shtëpitë e tyre.*

### Nga Brian Kuns, Zyra për qështje politike e Misionit të OSBE-së

Të drejtat e të kthyerve dhe të minoriteteve janë shumë me rëndësi, por njëherësh edhe çështje shumë sensitive dhe e politizuar në Kosovën e pas-luftës. Askush që është i involvuar në këtë proces, pavarësisht se cilit komunitet i takon apo për çfarë organizate punon, nuk është i kënaqur me status kuon e tanishme.

Sidoqoftë, një vit e gjysmë pas themelimit të Institucioneve të Përkohshme të Vetë-qeverisjes (IPV-ve), pas dy rezolutave të Kuvendit mbi kthimin e të zhvendosurve dhe pasi që liderët kryesorë shqiptarë dhe ata të minoriteteve përmes një letre publike fuqimisht kanë përkrahur kthimin e të zhvendosurve, është me rëndësi që të kemi parasysh kahjen e këtij debati në Kuvend, veçanërisht para fillimit të dialogut Prishtinë-Beograd.

Rezolutat e Kuvendit, si deklaratat zyrtare, dëshmojnë se politika e institucioneve të Kosovës mbështet të drejtën e të zhvendosurve për t'u kthyer. Ky fakt nuk duhet të anashkalohej. Gjithmonë kërkohet përgjegjësi për implementimin e duhur të

politikave të nivelit të lartë qeveritar, apo edhe për përkushtimin e liderëve. Megjithatë, tani është shumë më lehtë që të kërkohet llogari nga autoritetet, ngase ata e kanë vlerësuar që ka ardhur koha që publikisht të dalin me përkrahjen e tyre për kthimin e të zhvendosurve në vatrat e tyre. Pastaj, vetë akti i nxjerrjes së rekomandimeve të tilla dëshmon për bindjen se IPV duhet të luajnë një rol aktiv në procesin e kthimit të zhvendosurve dhe se këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me ndonjë kompetencë të rezervuar, apo çështje që i takon vetëm UNMIK-ut. Në të vërtetë, rekomandimi i nëntë i rezolutës së Kuvendit thekson qartazi se Kuvendi do ta mbikëqyrë implementimin e këtyre rekomandimeve.

Duhet të përmendet gjithashtu atmosfera e debatit, e cila ka ndryshuar nga ajo e vitit të kaluar kur Kuvendi nxorri rezolutën mbi këtë çështje. Megjithëse, debati u shfrytëzua si rast për akuza të ndërsjella- dhe në fund nuk votuan të gjitha grupet e Kuvendit pro këtyre rekomandimeve- kishte pa-

sur shembuj pozitivë kur deputetët e të dyja palëve kishin dhënë deklaratat pajtuese. Përveç kësaj, numri i votave kundër deklaratës së Kuvendit, për dallim nga viti 2002, ka rënë në vetëm një votë kundër në vitin 2003. Ende ka hapësirë për përmirësim e atmosferës së debateve të tilla, por është me rëndësi që të pranohet progresi që është arritur.

Çfarë është ndoshta më me rëndësi, rezoluta e fundit e Kuvendit i kontribuon krijimit të një tempore të shpejtë në tërë Kosovën në mbështetje të kthimit të të zhvendosurve. Kjo tempo është shtuar dukshëm gjatë tërë vitit deri më qershor, kur liderët kryesorë shqiptarë të Kosovës, së bashku me liderët e minoriteteve, botuan një ftesë publike, me anë të cilës ftoheshin të gjithë PZHV-të që të ktheheshin në vatrat e tyre. "Kosova është shtëpia juaj, ashtu siç është edhe jona; ne dëshirojmë dhe angazhohemi që ju të ktheheni dhe të jetoni në paqë si fqinjë, në frymën e respektit të përbashkët," thuhet në letër. Efekti i këtyre fjalëve tanimë është vërejtur, meqë të kthyerit e fundit në

Kosovë-në fshatin Bellopojë të komunës së Pejës-kanë pranuar sheshazi se kjo letër i ka inkurajuar që të vendosin ta rifillojnë jetën e tyre në Kosovë.

Politikanët e quajnë këtë "the Big Mo." "Mo" si momentum (tempo). Tempoja, në këtë rast, nënkupton një ndryshim pozitiv në një çështje në të cilën më herët nuk është arritur progres apo ky progres nuk është vërejtur. Kjo tempo arrihet përmes dëshmimeve të progresit, të zbutjes së qëndrimeve më parë të ngurta, apo nga dëshmia e bashkimit të palëve më parë kundërshtarë.

Në IPV-të janë duke i dhënë nxitje të vazhdueshme procesit të kthimit të zhvendosurve. Natyrisht, se është shumë me rëndësi që të jemi realistë. Mbetet ende për t'u bërë derisa ata që janë angazhuar në procesin e kthimit të zhvendosurve të jenë të kënaqur me të arriturat. Sidoqoftë, pas verës së vitit 2003, ka një tempo në drejtim të duhur në IPV-të, tempo që mund dhe duhet të ruhet e të përshpejtohet.

## “UNMIK dhe IPVT: Nevojiten dy për tango”

*I dërguari i ri i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), ish kryeministri i Finlandës Harri Holkeri, ka filluar punën në detyrën e re të kreut të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-un). Holkeri do ta drejtojë UNMIK-un gjatë periudhës më të vështirë që nga krijimi i tij. Qeveria e Kosovës gradualisht është duke marrë gjithnjë e më tepër përgjegjësi, dhe së këndejmi, bisedimet rreth statusit po afrohen. Megjithate, marrëdhëniet më kryesore të UNMIK-un me Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes janë tendosur në një shkallë të rrezikshme.*

**Nga Val Percival, ish Drejtoresh e GNK-së në Kosovë, Ilir Deda e Jehona Gjurgjeala,**



Grupi i Krizave Ndërkombëtare (GKN) kohë më parë ka bërë studime lidhur me këto marrëdhënie dhe konstatoi se marrëdhëniet e tendosura gjatë kohës sa Shtajneri ishte në krye të administratës ndërkombëtare shkaktuan mosmarrëveshje dhe armiqësi të panevojshme dhe i hutuan e i shpërqëndruan zyrtarët nga përpjekjet e tyre për ndërtimin e institucioneve demokratike. Së këndejmi, realizimi i objektivit kryesor- krijimit të institucioneve funksionale demokratike me kontrollë dhe balanc në degët gjyqësore, legjislative dhe ekzekutive të qeverisjes- ka rënë nën hijen e retorikës rreth asaj se kush duhet të fajsohet

për problemet e qeverisjes në Kosovës.

PSSP Holkeri ka një rast të veçantë që të mësojë nga gabimet e mëparshme të administratës së UNMIK-un, për t'i përmirësuar marrëdhëniet me IPVT, duke u angazhuar dhe siguruar që çdo mosmarrëveshje së pari, të pikaset dhe të identifikohet e më pas, të zgjidhet, duke penguar kështu rritjen e tensioneve dhe acarimin e situatës.

Ndër gabimet që ia vlen t'i përmendim është edhe agjenda politike mjaft ambicioze e UNMIK-un. Kështu PSSP-ja i mëparshëm z. Shtajner filloi me mjaft iniciativa, por shumica prej tyre mbetën në fazën e

konceptimit të tyre. Për më tepër, ai nuk u konsultua fare me personalitetet kryesore të Qeverisë dhe e shfrytëzoi vëmendjen e mediave. Monopolizimi i Shtajnerit me këtë vëmendje- si në tubimet vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare- ka bërë që Qeveria mos të jetë pothuajse fare e stimuluar që ta ushtrojë rolin e saj udhëheqës.

Aftësia e udhëheqësve qeveritarë për iniciativa është penguar nga vetë natyra e koalicionit qeveritar. Fjala vjen, ministrat u raportojnë krerëve të partive të tyre në vend se t'i raportojnë kryeministrit, i cili edhe ashtu është i kufizuar, ngaqë nuk e udhëheq partinë e tij. Qeveria nuk ka qenë në gjendje që të lansojë iniciativa politike ose që të zbatojë një platformë qeveritare koherente. Kuvendi nuk është duke ushtruar kontrollë efikase mbi degën e ekzekutivit, dhe rrallë ndonjëherë diskuton rreth punës së ministrave. Në vend të kësaj ata vëmendjen e përqëndrojnë më tepër në dështimet e UNMIK-un.

Harri Holkeri do të duhet ti

përmirësojë marrëdhëniet në mes të UNMIK-un dhe Qeverisë duke i adresuar çështjet që janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe të ndieshme- si bie fjala, bisedimet në mes të Beogradit dhe Prishtinës, bartja e kompetencave tek IPVT dhe strategjia e implementimit të standardeve. Ruajtja e raporteve profesionale dhe e bashkëpunimit me IPVT do të jetë e një rëndësie të veçantë, ngase do të mundësojnë që bashkëpunimi i këtyre të sjellë përparim e jo kthim prapa.

GNK rekomandon që z. Holkeri të krijojë dhe zhvillojë- në konsultim të plotë me Qeverinë, një agjendë politike më të qartë dhe më të përqëndruar. Holkeri do të duhej të inicone mbajtjen e mbledhjeve të nivelit të lartë dy herë në javë në mënyrë që të lehtësojë koordinimin e punës ndërmjet UNMIK-un dhe Qeverisë. PSSP-ja duhet të heq dorë nga të qenit në qendër të vëmendjes si në media ashtu edhe në tubimet ndërkombëtare dhe ta pranojë kontributin e dhënë nga zyrtarët e Qeverisë.

Në të njëjtën kohë edhe IPVT duhet ta ketë përgjegjësi në sigurimin e një bashkëpunimi sa më të mirë. IPVT është pala më e dobët në këto raporte- pa status të përcaktuar ndërkombëtarisht dhe e varuar nga UNMIK-u kur është fjala për raportin rreth progresit para Këshillit të Sigurimit. Zyrtarët e Kosovës duhet të pranojnë se bashkëpunimi me UNMIK-un është në interesin e tyre. Debatet dhe kundërshtitë publike nuk janë të dobishme; ata paqyrojnë reputacionin e Kosovës në një kohë mjaft të ndieshme ( para fillimit të bisedave rreth statusit). Zyrtarët e IPVT-së duhet të demonstrojnë një lidhshmëri më proaktive sa i takon zhvillimit dhe ruajtjes së dialogut dhe marrëdhënive konstruktive me UNMIK-un, duke punuar kështu gjithnjë për interesat e tyre. Për më tepër, tendencat e disa partive politike për ta penguar punën e Qeverisë duhet t'u ipet fund.

Për ta shtyer procesin përpara, IPVT-ja duhet të angazhohet në mënyrë më proaktive me UNMIK-un

rreth çështjeve me interes për IPVT. Ministrat e Qeverisë nuk duhet ta pengojnë punën e kryeministrit. Njëherësh, Qeveria duhet të përgatisë një platformë Qeveritare koherente, iniciativa të veçanta politike, dhe duhet që të sigurojë një konsensus me partitë politike për këto iniciativa. Veç kësaj, zyrtarët e lartë të pushtetit ekzekutiv, përfshirë këtu kryetarin Rugova, duhet t'i drejtohen Kuvendit rregullisht.

Fatet e UNMIK-ut dhe IPVT-së janë të pleksura. Për ta ruajtur kredibilitetin dhe për të siguruar një rol në misionet e ardhshme paqeuajtëse, misioni i KB-së ka nevojë që misioni i tij të përmbillet me sukses. IPVT-ja ka nevojë që të sigurojë një mbështetje të vazhdueshme ndërkombëtare në rrugën e vet drejt integritimit Evropian. Megjithatë, duket se asnjëra palë nuk e ka kuptuar ende se ata duhet ta ndajnë fatin e përbashkët. Për shkak të tundimeve dhe sprovave që i presin, do të ishte mirë që UNMIK-u dhe IPVT-ja të mësojnë nga lëshimet e tyre në të kaluarën dhe të punojnë së bashku për të ardhmen.

*Raporti i GNK-së mbi marrëdhëniet e IPVT-së dhe UNMIK-ut gjindet në website-in e GNK-së.*  
www.crisisweb.org

## Për një dinamikë të përsheptuar në bartjen e përgjegjësi

*Ndërtimi i institucioneve demokratike në Kosovë në periudhën e pasluftës, në pajtim me mandatin e përcaktuar me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB -së, ka qenë njëra ndër sfidat kryesore për misionin ndërkombëtar në Kosovë si dhe për vetë forcat politike të Kosovës*

**Fatmir Sejdiu (LDK), anëtar i Kryesisë në Kuvendin e Kosovës**

Ideja themelore e bartjes së kompetencave ndërlidhet me nevojën imediate për stabilizim të jetës normale në Kosovë. Kjo vlen për shumë sfera, përfshirë ringjalljen ekonomike të Kosovës, krijimin e kushteve për jetë normale të të gjithë qytetarëve të saj dhe funksionimin normal të institucioneve demokratike të dala nga vota e lirë e popullit.


Në të vërtetë, këto institucione, si në nivelin qendror, si në nivelet komunale, mbi këtë bazë e kanë ndërtuar mandatin e tyre. Ato bëhen bartëse të përgjegjësi të drejtëpërdrejtë në sfera të ndryshme, përfshirë procesin e vazhdueshëm të marrjes së përgjegjësi të rezervuara të PSSP-së. E fundit për nga radha, por jo edhe nga rëndësia, PSSP është përgjegjës për bartjen e përgjegjësi tek institucionet e Kosovës, siç është përcaktuar qartë edhe me Kornizën Kushtetuese.

Në radhët e vendorëve dhe ndërkombëtarëve, "standardet para statusit" kuptohen shpesh si "garë për

pushtet". Kjo nuk mund të kuptohet ndryshe, pos si gatishmëri e institucioneve të Kosovës për t'i ushtruar me përgjegjësi këto kompetenca, në pajtim me legjitimitetin e fituar. Nga përvoja e gjetëtanishme, përkundër rezultateve inkurajuese, kemi mësuar se ka pasur edhe ngecje sporadike në këtë proces, çfarë ka rezultuar në situata "ndeshjesh" e "tensionesh të ngritura" në lidhje me çështjet jetike për të ardhmen e Kosovës dhe popullit të saj.

Shikuar nga një kënd kritik, përcaktimi i "standardeve para statusit" si "detyrë shtëpie" në njërin anë, dhe mosbartja e përgjegjësi të drejtëpërdrejtë, në anën tjetër, mund të kuptohet edhe si një qëndrim i njëanshëm për zgjatjen e përhershme të këtij procesi. Kjo do të rezultonte në mbajtjen e status kuos.

Një qëndrim i tillë nuk është në përputhje me mandatin e supozuar të administratës ndërkombëtare në Kosovë. Nuk



është në përputhje as me dinamikën e zhvillimit të ngjarjeve në Kosovë, përkundër vështirësive që paraqiten në situatën e re në Kosovë, veçanërisht pas tri proceseve të sukseshme zgjedhore - dy në nivelin komunal e një në atë qendror.

Sfidat e tanishme, si në nivelin politik, ashtu edhe në atë ekonomik, me të cilat ballafaqohen institucionet e Kosovës, e shtojnë arsyeshmërinë për një

përsheptim të këtij procesi.

Ardhja e z. Harri Holkeri si PSSP i ri në Kosovë duhet të rezultojë në një përmbyshje të sukseshme të mandatit ndërkombëtar në Kosovë, duke respektuar dhe institucionalizuar njëkohësisht vullnetin politik të popullit të Kosovës për një Kosovë të lirë e demokratike. Fundja, kjo nuk është detyrë parësore e bashkësisë ndërkombëtare.

# Qeveria kërkon të marrë kompetencat mbi KEK-un,

*Kuvendi i Kosovës seancën plenare të 19 qershorit 2003 ka miratuar dhjetë rekomandime për tejklimin e gjendjes së rëndë energjetike në Kosovë. Deputetet votuan pro këtyre rekomandimeve pas një debati të gjatë të shoqëruar me kritika të drejtuar kundër menaxhimentit të Koorporatës Elektroenergjetike të Kosovës gjatë katër viteve të fundit.*

**Ridvan Berisha gazetar i RTK-së**

Dhjetë rekomandimet e miratuara pasqyrojnë gjendjen e mjerueshme energjetike në Kosovë, dhe menaxhimin e dobët të kësaj situatë nga ana e KEK-ut. Së këndejmi, Kuvendi dëshiron të formojë një komision për Energjetikë, si dhe Ministrinë e Energjetikës dhe të shqyrtojë mundësinë e ristrukturimit të KEK-ut, me qëllim që të bëhet më profitabil dhe më kompetitiv në tregun rajonal. Bajrush Xhemajli (PDK) Kryesuesi i Komisionit për Tregti dhe Industri, ka prezantuar rekomandimet me shpresë që Qeveria e Kosovës do të ndërmerr diçka.

Një panel i përbërë nga përfaqësues të Qeverisë së Kosovës dhe UNMIK-ut kanë vendosur që të formojnë një zyrë koordinative brenda Qeverisë, e cila do të merret ekskluzivisht me çështjet e energjisë, duke përfshirë këtu koordinimin e punës, investimet, produktivitetin dhe emërimet në KEK. Krijimi i kësaj zyreje ka ardhur si rezultat



*Bajrush Xhemajli*

i presioneve të bëra në debatet parlamentare, në Kuvendin e Kosovës, lidhur me KEK-ut.

Anëtarët e Koalicionit Kthimi, janë pajtuar pjesërisht me përmbajtjen e rekomandimeve. Shqetësimi i anëtarëve të Koalicionit Kthimi ka të bëjë me çështjen e kthimit të punëtorëve serb në KEK, dhe me përmirësimin e furnizimit me energji elektrike për minoritete dhe të kthyerit në Kosovë.

“Pasi që asnjëri nuk ka mundësi të ketë qasje në hetime dhe nuk mund të dijë se çfarë është situata faktike në KEK, atëherë iniciativa siç ka porpozuar paneli, është diçka që duhet përkrahur. Ka më shumë gjasa që përpjekjet e përbashkëta të UNMIK-ut dhe Qeverisë të gjejnë rrugëdalje nga qorrsoakaku.”- vuri në dukje Oliver Ivanoviq, anëtarë i Koalicionit Kthimi.

Para votimit, Bajrush Xhe-

majli ka prezentuar rekomandimet e Komisionit, ku mes tjerash, është kostatuar se faktori njeri është përgjegjës për situatën e tanishme të vështirë në KEK. Komisioni i udhëhequr nga z. Xhemajli, gjithashtu ka përmendur statusin e padefinuar të KEK-ut si një nga shkaktarët e humbjeve në punë gjatë këtyre viteve. Kjo situatë në anën tjetër ka ndikuar në prodhimin e ultë të thëngjillit, pasi që autoritetet serbe gjatë viteve 1990-1999 kanë dëmtuar një pjesë të madhe pajisjeve.

“Bazuar në analizat mbi rrëshqitjen e dheut në minjerën e Bardhit, më 9 nëntor 2002, edhe pesha e djerrinës, e cila nuk ishte hequr që një nga shkaktarët themelorë të fatkeqësisë së zjarrit në Obiliq”, pohoi deputeti Xhemajli. Ai tha se instituti shkencor vendor INKOS, kishte paralajmëruar për mundësinë e një fatkeqësie të tillë, mirëpo autoritetet menaxhuese ndërkombëtare nuk i kishin përfillur këto vërejtje. “Komisioni pas hetime të

bëra ka konstatuar se goditja e rrufesë nuk konstatohet, por se dëmet aq të mëdha, fajtor është faktori njeri” ka theksuar deputeti Xhemajli, duke i kritikuar dhe akuzuar për këtë gjë edhe ndërkombëtarët, të cilët sipas Xhemajlit nuk kanë lejuar ndërhyrjen e shpejtë të zjarrëfikësve.

Njëherësh, Komisioni ka kritikuar edhe mënyrën se si janë menxhuar investimet në KEK. “Është evidente se ka pasur vjedhje e keqpërdorime në udhëheqësinë e KEK-ut”, theksoi Xhemajli. Ai më pas vuri në dukje se hetimet rreth vjedhjeve tjera janë stopuar me ardhjen në detyrë të ish-top menaxherit. Z. Xhemajli në emër të Komisionit, propozoi formimin e një Komisioni ndërkombëtar të pavarur nga Qendra për Hetime Financiare që të bëjë hulumtime lidhur me këtë rast. Ndërsa lidhur me privatizimin e KEK-ut, ai tha se për këtë çështje nuk mund të flitet pa definimin e pronës dhe pronarit.

Udhëheqësi i grupit parlamentar të Lidhjes Demo-



kratike Sabri Hamiti, si edhe shumica e folësve, kërkuan nga UNMIK-u që të heqë dorë nga menaxhimi i KEK-ut, dhe t'ia bëjë kështu të mundur Qeverisë së Kosovës të marrë përgjegjësinë për sektorin Energjetik. "Nuk janë të gjithë ndërkombëtarët profesionalistë. Ata nuk janë aq të ditur dhe të aftë, dhe mosdijen e paaftësinë e tyre e mbulojnë me arsyetimin se ata i japin përgjegjësi tjetër kujt e jo Kosovës" - theksoi z. Hamiti në fjalimin e tij. Ai nuk është pajtuar me konstatimin e Komisionit për Tregti dhe Industri se keqpërdorues të mjeteve mund të jenë edhe stafi vendor i KEK-ut, apo edhe udhëheqësit vendor të KEK-ut. Hamiti poashtu, fajësoi Qeverinë e Kosovës për neglizhencë në kryerjen e obligimeve ndaj KEK-ut, në vend se të përkrahte hulumtimet lidhur me abuzimet eventuale nga udhëheqja vendore e KEK-ut.

Ministri për Ekonomi dhe Financa, Ali Sadria, reagoi dhe shprehe mospajtueshmërinë e tij lidhur me këtë. Sadriu nga ana e tij mes tjerash pohoi se "nuk është korrekte të sulmohet Qeveria për diçka për të cilën nuk ka kompetenca apo përgjegjësi".

Ndërkaq, Ramush Haradinaj, kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kërkoj marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes së krijuar për të bërë të mundur zbutjen e regjimit të reduktiveve gjatë stinës së dimrit. "Para së gjithash ne duhet të kemi një pasqyrë të menaxhimit në KEK", sugjeroi Haradinaj.

Çështja e energjisë elektrike në Kosovë, mbetet ende si kompetencë e rezervuar e PSSP-së. Sipas një zëdhënësi të UNMIK-ut, PSSP-ja mund të marrë masa edhe pasi të janë lexuar këto rekomandime në Kuvend, edhe pse, ai nuk është i obliguar të reagojë për ndryshime të caktuara për çështjet, të cilat janë të rezervuara.

Fillimi i shtatorit është shënuar me një mungesë të angazhimit nga ana e autoriteteve për të përmirësuar jetën qytetarëve të Kosovës. Ndërpreja e energjisë elektrike ngel tema më e diskutuar në të gjitha nivelet, dhe diskutimet e tilla mbi mundësinë e tejkalimit të situatës së këtu, janë mjaft shqetësuese.

Dhjetë rekomandime për të dalur nga kaosi energjetik në Kosovë

*Pas shqyrtimit të raportit të Komisionit për Tregti*

*dhe Industri mbi gjendjen në KEK dhe pas debatit parlamentar, Kuvendi i Kosovës me përkrahjen e grupeve parlamentare, në seancën plenare të mbajtur më 19 qershor të vitit 2003, me shumicë votash, ka miratuar këto rekomandime:*

1. Të formohet komisioni parlamentar për energjetikë;
2. Të nxirren ligjet për veprimtarinë e KEK-ut: ligji për energjetikë, ligji për minierat, ligji për kërkimet gjeologjike dhe ligji për organin e Rregullatorit;
3. Qeveria e Kosovës duhet

*të marrë sa më parë përgjegjësitë në fushën e energjetikës dhe të krijojë Ministrinë për Energjetikë;*

4. Të shqyrtohet mundësia e ristrukturimit të KEK-ut në mënyrë që të bëhet profitabil dhe konkurent në tregun rajonal të energjisë, derisa të nxirren ligjet relevante sistemore;
5. KEK-u duhet të kërkojë që të anëtarësohet si etnitet i veçantë në Institucionet e Sistemit Elektroenergjetikë të Evropës Juglindore;
6. Të përkrahet strategjia e ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike;

7. Të ndërtohet linja ndërlidhëse 400 KW në mes të Kosovës dhe të Shqipërisë;

8. Të përkrahet fuqishëm strategjia që KEK-un ta drejtojnë kuadrot vendase në të gjitha nivelet, ndërkaj kuadrat ndërkombëtare të marrin rolin e këshillëdhënësve;

9. Të përkrahet projekti KEK-PO, dhe të rritet efikasiteti veprues dhe financiar;

10. Kuvendi ta autorizojë Qendrën për Hulumtime Financiare (FIU) për hulumtimin e keqpërdorimeve eventuale në KEK.

#### Termocentrali në Obiliq



## Diskutimi rreth privatizimit

Thor Helsa, KTA

Të enjten me 3 korrik, Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM), agjensi kjo e menaxhimit ekonomik, e cila është krijuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë për të menaxhuar privatizimin e ekonomisë, prezantoi para anëtarëve të Kuvendit një brifing gjithëpërfshirës rreth procesit të privatizimit. Me këtë rast zyrtarët e AKM-së kërkuan mbështetjen e Kuvendit për tërheqjen e investitorëve.

Disa anëtarë të Kuvendit shprehën mendimin se kjo praktikë për të kërkuar përkrahje nga institucionet e Kosovës për t'i mbështetur proceset në të cilat nuk kanë qenë aktivisht të involvuar. Pas insistimit të kryetarit të Kuvendit

Nexhat Dacit, u vendos që deputetët e Kuvendit t'i dorëzojnë vërejtjet e tyre lidhur me procesin e privatizimit me shkrim, në mënyrë që më pas të përgatisin një draft të rekomandimeve për AKM-ën.

Që nga ky brifing ka pasur një varg zhvillimesh në programin e privatizimit. Objektivi dhe qëllimi i tyre kryesor nuk është që vetëm të gjenerojnë para të gatshme menjëherë, por edhe që të tërheqin ofertues, të cilët do të investojnë në Kosovë në planin afatgjatë dhe do të krijojnë vende të reja të punës.

Së këndejmi, rezultatet e shpalluara me 12 korrik, u vlerësuan si mjaft të sukseshme për Kosovën dhe më të mira

se që ishin parashikuar. Selia e AKM-së ka pranuar njëzet e dy oferta përfshirë shtatëmbëdhjetë të tjera që u dorëzuan një orë para skadimit të afatit të ofertimit. Nga këto 22 oferta, 5 janë refuzuar si të pavlefshme për shkak të dokumentacionit të pa kompletuar.

Shuma në total e ofertave në rrethin e parë ishte mbi €9,300,000, derisa shumata e përgjithshme për 6 tenderët e përkohshëm ishte mbi €4,600,000.

Ofertat arritën nga palët e interesuara prej vendeve të ndryshme si Austria, Bosna dhe Hercegovina, ish-Republika e Maqedonisë dhe Shqipëria. Menaxherët e ndërmarjeve të mëparshme në pronësi sho-

qërore (NPSH) paraqitën dy oferta.

Fill pas këtij rrethi të suksesshëm, Agjencia Kosovare për Mirëbesim organizoi raundin e dytë të tenderëve në javën e parë të muajit shtator. Kësaj rradhe bie në sy një rritje e konsiderueshme e investitorëve potencial: 180 investitorë konkurruan për 18 NPSH, që do të thotë afro 10 investitorë për NPSH. Shuma e përgjithshme e ofertave të dorëzuara në raundin e dytë ishte mbi €136,000,000, ndërkaq shumata totale e tenderëve të përkohshëm, që ishin dorëzuar, ishte mbi €24,500,000.

Xhiroja e tretë për privatizimin e NPSH-ve do të fillojë nga fundi i muajit shtator ku pritet të përfshihen ndërmar-

je nga më të ndryshmet si fjala vjen hotele, shitore, fabrika të specializuara për prodhimin e baterive, çilimave, plastikës, si dhe tullave, bukës, fabrika për prodhimin e materieve kimike dhe të ambalazhit.

Procesi i privatizimit në Kosovë do të vazhdojë edhe gjatë viteve 2003 dhe 2004 kur do të ketë shumë më tepër kompani nga industri dhe sektore të ndryshme të ekonomisë.

Informacione më të hollësishme lidhur me procesin e privatizimit mund të gjinden edhe në web faqen e Agjencionit Kosovar i Mirëbesimit:

[www.kta-kosovo.org](http://www.kta-kosovo.org)

KOSOVO TRUST AGENCY  
 Agjencia Kosovare për Mirëbesim i Ekonomisë  
 Prishtinë, Kosovë

# Puna jolegislative

*komponent i rëndësishëm i punës së komisioneve parlamentare*

**Edmond Efendia, NDI**

Puna e komisioneve përbëhet nga shumë funksione, duke përfshirë shqyrtimin dhe hartimin e ligjeve, por edhe punën hulumtuese mbi çështje të ndryshme, që bien nën jurisdiksonin e komisioneve dhe që mund të paraqesin shqetësim për qytetarët. Rrjedhimisht, komisionet nuk duhet të presin që qeveria t'u jap punë, por që në mënyrë proaktive të ndikojnë që qeveria t'i arrijë rezultatet më të mira. Raportet e komisioneve mbi mbikëqyrjen mund të sigurojnë që kjo të arrihet.

Çfarë është funksioni i komisioneve parlamentare? A është që vetëm t'i shqyrtojnë ligjet? Jo, ka shumë funksione që komisionet i kryejnë përveç shqyrtimit të ligjeve, dhe njëri nga ato është që komisionet duhet të sigurohen se qeveria e kryen punën e saj. Në të vërtetë, mbikëqyrja e ekzekutivit është njëri nga funksionet kryesore të parlamentit. Kjo do të thotë se komisionet parlamentare mbikëqyrin ministrin korrespondues. Mund të pyesim se a do të ishte e mundur të mbikëqyret në mënyrë efektive ekzekutivi pa u mbledhur informatat e nevojshme rreth një çështjeje të cak-

tuar? Përgjigja do të ishte - jo, na nevojitet ky informacion për ta ushtruar mbikëqyrjen. Është shumë e vështirë që të kemi ide se si qeveria do të mund ta përmirësonte punën e saj pa e kuptuar atë sferë të veçantë. Kjo është arsyeja pse komisionet shpesh organizojnë seanca për të mbledhur informatat. Deputetët jo gjithmonë janë ekspertë në çështjet të cilat i shqyrton komisioni. Kjo as nuk kërkohet dhe as nuk pritet detyrimisht nga ata, edhe pse ata mund të dëshirojnë këtë. Ata janë përfaqësues politikë dhe përmes mbledhjes së informatave ata mësojnë më tepër lidhur me një çështje, para se të marrin vendime politike lidhur me to.

Konkretisht, cilat mund të jenë funksionet e komisioneve përveç shqyrtimit apo hartimit të ligjeve? Komisionet mund të shqyrtojnë zbatimin e një ligji të miratuar, që bie në jurisdiksonin e tyre, dhe nëse ai ligj jep efektet e dëshiruara apo jo. Në rast se nuk jep efektet e dëshiruara atëherë cilat janë vështirësitë që ndeshen, cilat janë shkaqet e këtyre vështirësive dhe si mund të eliminohen

ato? Komisionet mund të vlerësojnë progresin e qeverisë në realizimin e programit të saj. Komisionet mund të shqyrtojnë shumë çështje të cilat mund të paraqesin shqetësim për qytetarët dhe si të tilla janë prioritete të komisioneve. E tërë kjo njihet si punë jolegislative e komisioneve parlamentare.

Kjo arrihet kur komisionet bëjnë hulumtime. Hulumtimet bëhen përmes dëgjimeve publike që mund të jenë të hapura për komentet e publikut. Në dëgjimet publike, përfaqësues nga Qeveria, organizatat qeveritare dhe joqeveritare, ekspertët dhe personat tjerë ftohen për të dëshmuar para komisionit parlamentar, duke paraqitur kështu pikëpamjet e tyre lidhur me temën e caktuar. Është jetësishëm e rëndësishme që komisioni të dëgjoj edhe nga qytetarët që janë më së shumti të prekur nga çështja në fjalë, e jo thjesht të mirret parasysh vetë ajo që thonë ekspertët. Në këtë mënyrë, komisioni është në pozitë që të mbledhë të gjitha faktet relevante dhe të përpilojë raportin e shkruar. Raporti përbëhet nga dy pjesë kryesore: një përshkrim i situatës faktike, si dhe rekoman-

dimet për veprimet të cilat duhet ndërmarrë nga qeveria. Raporti duhet të reflektoj faktet që komisioni i ka mbledhur nga dëshmitarët gjatë procesit të hulumtimit.

Në rrethanat e Kosovës, është e qartë se mungon legjislacioni në shumë fusha. Kështu që mund të pritet se rekomandimet nga raporti i komisionit, të cilat dalin nga hulumtimet përmes dëgjimeve publike, mund të përmbajnë udhëzime për qeverinë lidhur me hartimin e projektligjeve të caktuara. Për më tepër, komisioni përkatës mundet edhe t'i paraqesë qeverisë si do të dukej projektligji, në vija të trasha. Rekomandimet në raporte mund të bëjnë fjaë edhe për hapa konkret që komisioni i sugjeron qeverisë me qëllim të rritjes së efektivitetit të saj.

Është qenësore që hulumtimet të kurorëzohen me një raport të shkruar nga ana e komisionit. Raporti duhet të bëhet publik dhe të mundësohet një qasje e lehtë në të, si dhe duhet të shërbej si një mendim i informuar mirë i cili mund të ndihmojë Kuvendin, Qeverinë dhe trupat tjerë për të planifikuar veprimet e

ardhshme duke përfshirë këtu edhe legjislacionin.

Disa komisione në Kuvendin e Kosovës po bëjnë një punë shumë të mirë në këtë drejtim. Komisionet po bëjnë vizita në terren duke fituar kështu një kuptim më të mirë mbi çështje të caktuara. Komisioni për Tregëti dhe Industri ka përpiluar raportin lidhur me situatën në KEK. Jemi në dijeni që i njeiti komision po punon edhe në një raport tjetër rreth gjendjes së minierave në Kosovë. Praktikata e tillë duhet të zgjerohet edhe në komisionet tjera parlamentare. Organizatat në kuadër të Iniciativës për Përkrahjen e Kuvendit (ang. ASI) janë të gatshme të ndihmojnë komisionet lidhur me organizimin e dëgjimeve publike dhe hartimit të raporteve me shkrim.

Të keshë komisione aktive do të thotë të keshë një parlament të fuqishëm - të aftë për të mbikëqyruar ekzekutivin dhe për ta mbajtur atë të përgjegjshëm. Në fund të fundit, kjo është ajo që të gjithë ne edhe e dëshirojmë - të nxjerrim maksimumin nga qeveria.

# Faza e parë e projektit Speak: Krijimi i Sistemit të Menaxhimit të Dokumenteve të Kuvendit

*Më 12 gusht, me arritjen e z. Roxher Roj, ekspert në administrim, filloi puna në projektin 'Mbështetje Arkivave Elektronike parlamentare në Kosovë'. Detyra parësore e z. Roj do të jetë krijimi i Sistemit të Menaxhimit të Dokumenteve për Kuvendin e Kosovës. Kjo komponentë e rëndësishme e projektit Speak është duke u financuar nga AER me një ndihmë prej €199,700 nga UNDP.*

**Krenar Loshi, Analist Administrata Publike UNDP Kosovo**



Krijimi i Sistemit të Menaxhimit të Arkivave (SMA) do të sigurojë një rrjedhë të qartë të dokumentacionit për një funksionimin adekuat dhe të duhur të Kuvendit të Kosovës. SMA-ja, para se të gjithash, ka për qëllim të krijojë dhe të mundësojë një punë dhe aktivitet të vazhdueshëm mbrenda Kuvendit të Kosovës si dhe të harmonizojë mënyrën e menaxhimit të arkivave. Të gjitha dokumentet do të jenë të standardizuara dhe mënyra e funksionimit të menaxhimit të arkivave do të jetë 100% elektronike. SMA-ja do të sigurojë

që shfrytëzuesit të kenë mundësi optimale për shfrytëzimin e burimeve, dhe qasje në kohë të duhur në arkivat e Kuvendit. Në këtë fazë fillestare, do të krijohen materialet arkivore të shtypura dhe elektronike për shfrytëzim në të ardhmen.

SMA-ja e integruar do të ofrojë një sistem elektronik për regjistrimin dhe ruajtjen e dokumenteve, të cilat kanë të bëjnë me problemet dhe çështjet që janë pjesë e procesit vendim-marrës të Kuvendit. Veç kësaj, do të sigurojë që dokumentet dhe çështjet e stafit të regjistrohen në mënyrë të standardizuar, ashtu që i tërë teksti i dokumentit të ruhet në tërësi. SMA-ja do t'ia mundësojë stafit të Kuvendit të Kosovës të bëjnë hulumtime të ndryshme (p.sh hulumtimin Bulian, hulumtimin të fjalëve, fragmente apo sekuencave të tëra). Kjo do të jetë mjaft e dobishme dhe e mirëseardhur, ngase do të shtohet vëllimi i të dhënave

dhe dokumenteve të Kuvendit të Kosovës, duke vështirësuar kështu hulumtimin e teksteve të thjeshta. Njëherësh, Stafit i Kuvendit të Kosovës do të ketë mundësi t'i ruaj dhe rikthej dokumentet në mënyrë elektronike, t'i publikoj ato si në letër ashtu edhe në mënyrë elektronike, me kohë, dhe në mënyrë të shpejtë dhe të përpiktë. Puna duhet të bëhet dhe zhvillohet konform Rregullave të Procedurës së Kuvendit të Kosovës.

Për të pasur sukses SMA-ja, është me rëndësi që të bëhet identifikimi dhe kategorizimi i të gjitha dokumenteve dhe përcaktimi i poseduesit të dokumenteve, autorizimeve, ruajtjes dhe publikimit. Tekstet, audio dhe video materialet duhet të ruhen sipas thesarit dhe sistemit arkivor që mundëson rikthim të shpejtë dhe të përpiktë. Dizajnimi i programeve të nevojshme kompjuterike do të marrë mjaft kohë. Të gjitha mate-

rialet origjinale të shtypura do të regjistrohen dhe ruhen në arkivën e njëjtë, përkatësisht në Bibliotekën e Kuvendit dhe Seksionin Arkivor, të cilat njëkohësisht do të kenë kopje të materialeve të shtypura për t'i huazuar.

Njëherësh në bashkëpunim me Arkivën Kombëtare, do të krijohet sistemi i arkivimit të materialeve të shtypura, duke marrë parasysh versionet e nevojshme gjuhësore. Shëmbëllyeshëm, do të krijohet edhe një sistem për arkivimin e postës ditore. Vetëm dokumentet, të cilat do të kërkohen nga Kuvendi, hulumtuesit, studentët dhe gazetarët do të përfshihen në sistemin e arkivimit

Veç kësaj, do të diskutohet lidhur me atë nëse arkivi i dokumenteve do të integrohet në sistemin e të dhënave të Qeverisë apo Sistemin e të Dhënave Ligjore, që është duke u zhvilluar nga Zyrja e Kryeministrit. Për më tepër, këto diskutime do të përcaktojnë kush do të jetë

redaktori përgjegjës i një gazete zyrtare bazuar në informacionet nga këto të dhëna të dokumenteve.

Trainimi i stafit, i cili do të mundësohet nga projekti SPEAK është i një rëndësie të veçantë, ngase ka për qëllim njohjen e aspekteve teknike, të procedurave të arkivimit dhe nevojës për aplikuar një disiplinë në shfrytëzimin e procedurave teknike dhe rutinave të punës.

Dizajni i sistemit të arkivimit të dokumenteve do të bëhet pas konsultimeve të hollësishme me stafin e Kuvendit të Kosovës, me qëllim që të njihemi më mirë dhe më saktësisht me nevojat dhe dëshirat e tyre. Kjo do të jetë detyra parësore e menaxherit të projektit. Shfrytëzimi i sistemit do të bëhet që nga faza fillestare, për t'u shndërruar më pas në një mundësi dhe mjet të mirëseardhur dhe mjaft të dobishëm për punën e stafit të Kuvendit të Kosovës.

# Kuvendi i Kosovës nxjerrë Buletinin

*Në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, Zyra për Marrëdhënie me Media dhe Publikime në kuadër të programit të saj ka paraparë edhe nxjerrjen e Buletinit të Kuvendit. Numri i parë i Buletinit doli më qershor. Në lidhje me këtë, biseduam me Z. Sherif Konjufca, Përgjegjës i Zyrës për Marrëdhënie me Media dhe Publikime.*

## Intervistoi: Edmond Efendija, NDI

ASI: Cili është qëllimi i publikimit të buletinit të Kuvendit?

**Sh. Konjufca:** Është shumë e rëndësishme që Kuvendi, si institucioni më i lartë legjislativ i vendit, ta ketë një organ të tij të shkruar, në të cilin pasqyrohen aktivitetet e mekanizmave të Kuvendit, që nga seancat plenare, aktivitetet e kryetarit dhe të anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit, puna e komisioneve parlamentare dhe përgjithësisht puna e deputetëve etj. Buletini gjithsesi mëton të jetë edhe një tribunë e mendimit të lirë të deputetëve dhe e ideve që mund të ishin të dobishme për qeverinë (cytje për aktivitet dhe për përgatitjen e projektligjeve) dhe çështje që do të trajtoheshin në seancat plenare të Kuvendit, etj.

ASI: Sa është tirazhi i botimit, ku mund të kërkohet buletini i

Kuvendit dhe sa janë të informuar njerëzit për këtë revistë?

**Sh. Konjufca:** Për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gazetareve (aktualisht jemi vetëm tre veta), Buletini është menduar që fillimisht të jetë publikim ndërmjet gazetës dhe kronikës së aktiviteteve në Kuvend, që botohet një herë në muaj. Kjo paksa ka ndryshuar, meqë zyra jonë është e vogël dhe ne jemi duke u marrë me informacionin nga aktivitetet e përditshme të Kuvendit. Ne vendosëm që buletinin t'ua dedikojmë deputetëve, insitucioneve të Kosovës, kuvendeve komunale, analistëve, gazetarëve etj, që të përdoret nga qeveria e që të mos jetë në shitje të lirë. Fillimisht Buletini botohet në 1000 kopje (600 kopje në shqip dhe nga 200 në serbisht dhe turqisht).

ASI: Çfarë mund të lexohet në buletinin e

Kuvendit të Kosovës?

**Sh. Konjufca:** Tash dhe në të ardhmen mund të lexohen artikuj të ndryshëm, përfshirë: debatet e deputetëve në lëmin e miratimit të legjislacionit dhe dokumenteve që miraton Kuvendi; të dhëna mbi takimet protokolare dhe të aktiviteteve të komisioneve të Kuvendit; komentet e Kryetarit të Kosovës; komentet e Kryeministrit dhe të ministrave të qeverisë si dhe deklaratat e ekspertëve që janë ftuar ta thonë fjalën e tyre gjatë seancave të Kuvendit.

ASI: Si do të duket buletini pas një viti?

**Sh. Konjufca:** Synojmë që me kohë të zgjerohet dhe të profesionalizohet stafi i redaksisë dhe gradualisht buletini të bëhet një gazetë javore e Kuvendit të Kosovës, profesionale dhe dinamike, interesante dhe atraktive edhe për lexuesin e gjerë. Për këtë

qëllim kemi analizuar shpejt mund të disa modele të shpeshtohet botimi, të publikimeve të ngjashme shtohet tirazhi dhe nga mbarë Evropa. Buletini të shtypet edhe Shpresojmë që me një në ndonjë gjuhë botërore, mbështetje modeste të të gjithë fillimisht në interesuarve shumë anglisht. .



## AKTIVITETET TJERA MBËSHTETËSE PËR KUVENDIN

### **Trajnimi për të drejtat e njeriut për Koalicionin "Kthimi" dhe komunitetet tjera.**

Më 14 korrik 2003, anëtarët e grupit parlamentar të sërbevëve të Kosovës-grupi parlamentar Koalicioni "Kthimi", kanë marrë pjesë në sesionin e trajnimit mbi mbrojtjen e të drejtave të minoritarëve, organizuar nga Departamenti i Demokracizimit të OSBE-së në bashkëpunim me zyrën e Komisarit të lartë për të Drejtat e Njeriut. Deputetët janë njohur mbi parimet themelore të të drejtave të njeriut, dhe janë këshilluar për mënyrën e formulimit të strategjisë dhe politikës mbrojtëse të bazuar në parimet për të drejtat e njeriut në punën e tyre parlamentare. Një sesion tjetër është mbajtur për parlamentarët e komuniteteve të tjera më 16 korrik 2003. Tema kryesore të diskutimit ishin: gjuhët e minoriteteve, të drejtat për arsim dhe qasja e deputetëve jo-shqiptarë dhe jo-sërbevë në mediat qëndrore.

### **Avokatët e komuniteti RAE vizituan Kuvendin e Kosovës**

Më 26 qershor, sekretariati i Kuvendit dhe OSBE-ja kanë organizuar një vizitë në Kuvendin e Kosovës, për grupin e avokatëve romë, ashkalinjë dhe egjiptian. Kjo ishte hera e parë që anëtarët e komunitetit RAE vizituan Kuvendin me ç'rast atyre iu është bërë e mundur të shetisin në ndërtesën e Kuvendit, t'i përcjellin sesionet plenare dhe të njihen më për së afërmi me procedurat e tij. Debatu mbi çështjet e arsimit ishte me interes të veçantë për avokatët.

### **Rezultati i tenderëve të AER-së për Kuvendin**

Agjencioni Europian për Rindërtim ka inicuar një program mbështetës për Kuvendin e Kosovës. Kështu, një tender për partnerin implementues të programit është kryer së bashku me "Partneritetin" e përbërë nga parlamentet e Francës, Gjermanisë dhe Belgjikës. Shkurt, programi i AER parasheh që të: Përforëcojë aftësitë profesionale dhe shkathësitë tek-

nike të deputetëve të Kuvendit, njësisë ligjore të Kuvendit dhe stafit të Kuvendit;

Ofrojë ndihmë sesioneve plenare të Kuvendit dhe komisioneve, veçanërisht kur bëhet fjalë për harmonizimin e legjislacionit me standardet europiane dhe *acquis communautaire*;

Mbështet zhvillimin e Rregullave të Procedurave të Kuvendit në bashkëpunim me gjithë faktorët e involvuar në këtë lëmi;

Mbështet shërbimet gjuhësore në Kuvend.

Këto projekte do të realizohen në sajë të ndihmës së ekspertëve për çështje ligjore dhe procedurale nga parlamentet tjera mbështetëse. Kjo punë do të përqendrohet në përmirësimin e administratës dhe në aftësimin e kuadrove, ku njëherësh do të kërkohet kontributi i ekspertëve vendorë. AER dhe 'Partneritetin' janë duke bashkëpunuar me donatorët tjerë të Kuvendit mbrenda kornizës së Inicativës për Mbështetje Kuvendit të Kosovës.

### **Programi i Intershipit 'Friedrich Ebert Stiftung'**

Programi i intershipit mëton që të involvojë dhe angazhojë studentët, të cilët dëshirojnë të punojnë së bashku me komisionet, për t'u ndihmuar atyre në shqyrtimin e ligjeve. Intershipi 6 mujor, i sponsoruar nga FES, Fondacioni Soros dhe Universiteti i Prishtinës, fillon në shtator dhe mbaron në nëntor 2003. Departamenti i Shkencave Politike i Universitetit të Prishtinës ka inicuar këtë program, duke marrë parasysh mungesën e stafit të kualifikuar të ekspertëve ligjor në Kuvend, nga e cili do të përfitojnë si stafi i Kuvendit ashtu edhe studentët. Kandidatët e suksesshëm, që do të zgjedhen nga shumica e studentëve, do të njihen me rregullat e punës së Kuvendit të Kosovës para se të fillojnë me punën e tyre.

### **Vizita e fondacionit 'Friedrich Ebert Stiftung' në Bosnë**

Në vazhdim të aktivitetëve të sukseshmë të programit rajonal për shkëmbim, në fillim të tetorit 2003, FES

do të organizojë një vizitë në B&H për anëtarët e Komisioneve për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Shërbime Publike, Ambient dhe Shëndetësi, të Kuvendit.

### **Trajnimi i 'Friedrich Ebert Stiftung' & ANTTARC mbi fjalimet publike**

Me 4 korrik të vitit 2003, në Prishtinë, u mbajt programi trajnues mbi marrëdhëniet publike dhe komunikim me media për deputetët e Kuvendit të Kosovës, i cili u udhëhoq nga ANTTARC dhe u financua nga FES. Qëllimi i këtij sesioni ishte zhvillimi i kapaciteteve dhe shkathësitëve për komunikim me media, dhe në veçanti rritja e njohurive dhe aftësive mbi mjetet efektive të komunikimit, teknikat e fjalimeve publike. Fushat ku u përqëndrua trajnimi ishin marrëdhëniet publike dhe rëndësia e tyre si mjet komunikimi i institucioneve, taktikat e komunikimit dhe udhëzimet si të sillen dhe të komunikojnë me media, si dhe këshilla rreth dhënies së intervistës në mediat elektronike.

PROGRAMI LEGJISLATIV I QEVERISË DHE KUVENDIT  
DERI MË 1 GUSHT 2003 (që nga shqyrtimi i parë)

Nr	Niveli dhe titulli i projektit	Niveli i detyrimit	Organi i përgjegjës	Procedura legjislative
1	PKK/PK/130/03 - Ligji për ndërtimin e rrugëve të reja	Konstituante/2	1 Mars 2003	PKK/PK/130/03 (PK/130/03) 08.03.03
2	PKK/PK/131/03 - Mbrojtja e shpatave dhe shtrimeve	PKK/PK/131/03	11 Mars 2003	PKK/PK/131/03 (PK/131/03) 14.03.03
3	PKK/PK/132/03 - Mbrojtja e shpatave dhe shtrimeve	PKK/PK/132/03	11 Mars 2003	PKK/PK/132/03 (PK/132/03) 14.03.03
4	Ligji për rregullimin e procedurës së regjistrimit të pronave të tokës në shtet	Konstituante/2	Konstituante	PKK/PK/133/03 (PK/133/03) 15.03.03
5	PKK/PK/134/03 - Detyrimi i punëve të punës	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/134/03 (PK/134/03) 20.03.03
6	PKK/PK/135/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/135/03 (PK/135/03) 20.03.03
7	PKK/PK/136/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/136/03 (PK/136/03) 20.03.03
8	PKK/PK/137/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/137/03 (PK/137/03) 20.03.03
9	PKK/PK/138/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/138/03 (PK/138/03) 20.03.03
10	PKK/PK/139/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/139/03 (PK/139/03) 20.03.03
11	PKK/PK/140/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/140/03 (PK/140/03) 20.03.03
12	PKK/PK/141/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/141/03 (PK/141/03) 20.03.03
13	PKK/PK/142/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/142/03 (PK/142/03) 20.03.03
14	PKK/PK/143/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/143/03 (PK/143/03) 20.03.03
15	PKK/PK/144/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/144/03 (PK/144/03) 20.03.03
16	PKK/PK/145/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/145/03 (PK/145/03) 20.03.03
17	PKK/PK/146/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/146/03 (PK/146/03) 20.03.03
18	PKK/PK/147/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/147/03 (PK/147/03) 20.03.03
19	PKK/PK/148/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/148/03 (PK/148/03) 20.03.03
20	PKK/PK/149/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/149/03 (PK/149/03) 20.03.03
21	PKK/PK/150/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/150/03 (PK/150/03) 20.03.03
22	PKK/PK/151/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/151/03 (PK/151/03) 20.03.03
23	PKK/PK/152/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/152/03 (PK/152/03) 20.03.03
24	PKK/PK/153/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/153/03 (PK/153/03) 20.03.03
25	PKK/PK/154/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/154/03 (PK/154/03) 20.03.03
26	PKK/PK/155/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/155/03 (PK/155/03) 20.03.03
27	PKK/PK/156/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/156/03 (PK/156/03) 20.03.03
28	PKK/PK/157/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/157/03 (PK/157/03) 20.03.03
29	PKK/PK/158/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/158/03 (PK/158/03) 20.03.03
30	PKK/PK/159/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/159/03 (PK/159/03) 20.03.03
31	PKK/PK/160/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/160/03 (PK/160/03) 20.03.03
32	PKK/PK/161/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/161/03 (PK/161/03) 20.03.03
33	PKK/PK/162/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/162/03 (PK/162/03) 20.03.03
34	PKK/PK/163/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/163/03 (PK/163/03) 20.03.03
35	PKK/PK/164/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/164/03 (PK/164/03) 20.03.03
36	PKK/PK/165/03 - Ligji për shërbimet publike	Konstituante/2	17 Mars 2003	PKK/PK/165/03 (PK/165/03) 20.03.03

## Deklarata e Misionit të ASI-t

Si koordinatorë e programeve për demokratizim për agjensitë që përkrahin Kuvendin e Kosovës, Iniciativa për Përkrahjen e Kuvendit (ASI) synon që ta forcojë dhe profesionalizojë Kuvendin e Kosovës në zhvillimin e aftësive në mënyrë që sa më parë të shndërrohet në një Kuvend stabil, funksional dhe efikas, i cili në vepron në përputhje me sundimin e ligjit dhe në mënyrë të barabartë në emër të të gjitha bashkësive dhe qytetarëve.

Anëtarët e iniciativës do të punojnë për t'i përqëndruar forcat e përbashkëta rreth një qëllimi të përbashkët që do të mundësojë përparimin në drejtim të arritjes së këtij pikësnyimi. Puna e ASI-it do të përqëndrohet në kulturën politike demokratike duke u mbështetur në njohuritë dhe respektimin e rregullave demokratike të procedurës, transparencën dhe përgjegjësinë ndaj popullit, në zbatimin e rendit legjislativ, mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe në respektin ndaj shumëgjyohësish në Kuvend.

Si një koordinatorë në mes të agjensive që përkrahin Kuvendin e Kosovës, ASI përkrahë Kuvendin përmes konferencave dhe trajnimeve, seminareve me komisioneve, ndihmës teknike për Kryesinë, për krerët e komisioneve dhe për delegatët e Kuvendit, përmes vizitave të bëra parlamenteve të vendeve të ndryshme, trajnimeve për personelin legjislativ dhe për përkthyesit e Kuvendit. Përpos kësaj, edhe puna e këshilltarëve të Kuvendit dhe komisioneve të tij është pjesë e koordinimit të ASI-t.

### Pjesëmarrësit e tanishëm të ASI-t:

*Këshilli për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut - KMDLNJ, Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung (FES), Fondacioni Friedrich Naumann Stiftung (FNS), Konrad Adenauer Stiftung, Projekti për Praktikën Parlamentare Lindje-Perëndim (Holandë), Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), Agjensioni SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Kombëtarë Demokratik (NDI), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërpalamentar (IPU), Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së dhe Sekretariati i Kuvendit me përkrahjen aktive të zyrës së Kryeministrit, të zyrave të shtyllës së IV të UNMIK-ut UE-së dhe të zyrave përfaqësuese në Prishtinë, siç janë: zyra e Austrisë, Belgjikës, Gjermanisë, Italisë, Holandës, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.*



*Fotografitë në këtë numër:*

*OSCE: pg. 2, 4, 5, 9, 10, 11, 14, 15, 16, 17, Rondorf: pg. 3*

